VENDIM
Nr. 420, datë 8.6.2016

PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT SHTETËROR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(Ndryshuar me VKM nr. 822, datë 22.11.2017; nr. 587, datë 9.10.2018; nr. 573, datë 6.10.2021; nr. 125, datë 2.3.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 23/2015, datë 19.3.2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Ceremonialit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr. 229, datë 23.4.2004, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Ceremonialit Zyrtar të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Niko Peleshi

CEREMONIALI SHTETËROR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kapitulli I. Protokolli i Shtetit
Kapitulli II. Marrëdhëniet me trupin diplomatik
Kapitulli III. Simbolet e Republikës
Kapitulli IV. Ceremoniali i autoriteteve më të larta të shtetit
Kapitulli V. Vizita dhe takime
Kapitulli VI. Radha e përparësisë dhe aktivitet ceremonial
Përparësia në Republikën e Shqipërisë
Kapitulli VII. Privilegje dhe imunitete
Kapitulli VIII. Skemat të ceremonive shtetërore dhe zyrtare

CEREMONIALI SHTETËROR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ceremoniali Shtetëror i Republikës së Shqipërisë është instrumenti juridik dhe organizativ nëpërmjet të cilit shteti shqiptar ushtron veprimtarinë e tij protokollare të tagreve, privilegjeve dhe detyrave të përcaktuara nga Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare të detyrueshme për t'u zbatuar, ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si edhe doket e mira ndërkombëtare.

Protokolli përbëhet nga bashkësia e normave të shkruara dhe të pashkruara, që caktojnë përparësitë shtetërore dhe diplomatike, rregullat e shkëmbimeve të shkruara, verbale dhe materiale midis administratës së brendshme dhe midis shteteve, sistemin e nderimeve dhe dekoratave, privilegjet dhe imunitetet, kushtet e negociatave ndërkombëtare dhe përshkallëzimin racional dhe estetik të ceremonive publike që kanë të bëjnë me funksione të larta civile dhe ushtarake.

KAPITULLI I
PROTOKOLLI I SHTETIT

1. Protokolli i Shtetit, strukturë në varësi të ministrit të Punëve të Jashtme, është garante dhe përgjegjëse e mbarëvajtjes së Ceremonialit Shtetëror. Protokolli i Shtetit ka disa funksione të rëndësishme, të cilat kryhen drejtpërdrejt nga kjo strukturë, ose nën bashkërendimin e saj nga zyra të tjera protokolli pranë institucioneve qendrore dhe vendore, të cilat e organizojnë veprimtarinë protokollare në kuadër të këtij ceremoniali.

2. Protokolli i Shtetit ka si mision:

2.1 Bashkërendimin e veprimtarisë protokollare të institucionit të Presidentit të Republikës, kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme, brenda dhe jashtë vendit;

2.2 Bashkërendimin e veprimtarisë protokollare të anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe drejtuesve të institucioneve të larta qendrore, unifikimin e praktikave ceremoniale dhe protokollare në përputhje me parimet bazë të Ceremonialit Shtetëror;

2.3 Bashkërendimin dhe zbatimin e programeve të vizitave zyrtare të delegacioneve të huaja të nivelit më të lartë shtetëror;

2.4 Vendosjen e komunikimit dhe mbikëqyrjen e realizimit të privilegjeve dhe imuniteteve diplomatike për misionet diplomatike, postet konsullore, organizatat ndërkombëtare me status diplomatik të akredituara në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me kuadrin ligjor, parimin e reciprocitetit dhe doket e mira ndërkombëtare.

3. Protokolli i Shtetit kryen këto funksione:

3.1 Zbaton me saktësi radhën e përparësisë së rangjeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë, trupit diplomatik të përcaktuara në këtë ceremonial. Përcakton radhën e përparësisë për rastet e paparashikuara në këtë ceremonial;

3.2 Bashkërendon mbarëvajtjen e ceremonive të pritjes e të përcjelljes së delegacioneve të huaja të rangut, kryetar shteti, kryetar qeverie dhe ministër i Punëve të Jashtme. Harton, në bashkëpunim me kabinetet e Presidentit, Kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme, programin e vizitës së tyre dhe ndjek zbatimin e tij;

3.3 Disiplinon përdorimin e simboleve kombëtare, shtetërore të Republikës së Shqipërisë dhe të shenjave të tjera zyrtare gjatë veprimtarive protokollare;

3.4 Sugjeron nivelin e përfaqësimit dhe të pjesëmarrjes së personaliteteve të larta shtetërore në veprimtaritë dhe pritjet kombëtare që organizohen nga përfaqësitë e huaja;

3.5 Koordinon takimet e Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe të ministrit të Punëve të Jashtme me përfaqësuesit diplomatikë të akredituar në Republikën e Shqipërisë;

3.6 Bashkërendon shkëmbimin e telegrameve, të korrespondencës zyrtare të Presidentit të Republikës, kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe të ministrit të Punëve të Jashtme, me personalitetet e larta të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare;

3.7 Adreson qarkore dhe udhëzime institucioneve shtetërore dhe trupit diplomatik nëpërmjet të cilave kumton dhe interpreton bazën normative të Ceremonialit dhe të Protokollit, unifikon praktikën protokollare;

3.8 Është i autorizuar që në respektim të reciprocitetit dhe marrëveshjeve në fuqi të kërkojë lehtësimin ose përjashtimin nga taksat kufitare të personave apo delegacioneve të huaja zyrtare që vijnë në Shqipëri.

4. Zyrat e protokollit të institucioneve të larta shtetërore

4.1 Pranë institucioneve të larta shtetërore, funksionojnë zyrat e protokollit, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e praktikave ceremoniale në shërbim të titullarëve të këtyre institucioneve;

4.2 Protokolli i Shtetit mban lidhje të ngushta me protokollet e institucioneve qendrore.

KAPITULLI II
MARRËDHËNIET ME TRUPIN DIPLOMATIK

Protokolli i Shtetit përcakton, në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961 dhe Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963, formalitetet që respektohen për ardhjen dhe largimin nga Shqipëria të funksionarëve diplomatikë, veçoritë e statusit të tyre, imunitetet, privilegjet e trupit diplomatik.

1. Akreditimi i shefit të misionit diplomatik

1.1 Kërkesa e agrementit i dërgohet Drejtorisë së Protokollit të Shtetit me notë verbale, të shoqëruar me jetëshkrimin e shefit të misionit, nëpërmjet përfaqësisë diplomatike të shtetit dërgues të akredituar në Republikën e Shqipërisë.

1.2 Pas dhënies së vlerësimit nga strukturat përkatëse të shtetit shqiptar, Protokolli i Shtetit njofton me notë verbale përfaqësinë diplomatike të palës kërkuese mbi dhënien e agrementit. Si rregull, afati kohor për dhënien e agrementit bazohet në parimin e reciprocitetit.

2. Mbërritja e shefit të ri të misionit dhe paraqitja e letrave kredenciale

2.1 Përfaqësia diplomatike përkatëse, me notë verbale, njofton Protokollin e Shtetit mbi detajet e mbërritjes në Shqipëri të shefit të ri të misionit.

2.2 Shefi i ri i misionit pritet në sallën VIP të Aeroportit "Nënë Tereza" nga zyrtari i Protokollit të Shtetit, i cili i komunikon datën e takimit me drejtorin e Protokollit të Shtetit, për dorëzimin e kopjeve të letrave kredenciale dhe të letërthirrjes së paraardhësit. Procedura e ceremonisë së paraqitjes së letrave kredencialeve te Presidenti i Republikës i dorëzohet dhe i shpjegohet gjatë këtij takimi.

2.3 Procedura e paraqitjes së letrave kredenciale miratohet me urdhër të ministrit të Punëve të Jashtme.

2.4 Që prej këtij momenti, ai konsiderohet si ambasador i emëruar dhe mund të vijojë detyrën e tij, por nuk ka të drejtë të takojë drejtuesit e institucioneve qendrore dhe vendore. Shefit të ri të misionit i rekomandohet formalisht të shmangë çdo lloj prononcimi publik në media përpara se të paraqesë kredencialet.

2.5 Ceremonia e dorëzimit të letrave kredenciale te Presidenti i Republikës, si rregull, bëhet në grupe jo më të vogla se tre ambasadorë njëherësh. Grupet formohen si me ambasadorë, të cilët janë rezidentë, ashtu edhe me ambasadorë që nuk janë rezidentë në Tiranë. Koha për dorëzimin e letrave kredenciale nga shefat e misioneve që përbëjnë grupin, si rregull, nuk duhet të zgjasë më shumë se dy muaj nga data e paraqitjes së kërkesës së anëtarit të grupit që ka dorëzuar kopjet e letrave i pari. Si radhë për dorëzimin e letrave kredenciale merret koha e mbërritjes në Tiranë.

2.6 Pas paraqitjes së kredencialeve, Protokolli i Shtetit informon shefin e ri të misionit për takimin me ministrin e Punëve të Jashtme ose me një zyrtar të deleguar prej tij. Takimet me zyrtarë të tjerë qendrorë dhe lokalë realizohen pas takimit të kortezisë me ministrin e Punëve të Jashtme.

2.7 Protokolli i Shtetit, bazuar në kërkesën e shefit të ri të misionit, ndihmon në realizimin e takimeve të kortezisë me rastin e fillimit të detyrës me kryetarin e Kuvendit dhe me Kryeministrin. Këto takime konsiderohen të kryera nëse shefi i misionit pritet nga një zyrtar i autorizuar nga secili personalitet i lartë.

2.8 Përfundimi i detyrës së shefit të misionit njoftohet me notë verbale nga misioni përkatës drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme.

2.9 Misioni njofton me notë Protokollin e Shtetit për detajet e largimit të shefit të misionit. Ditën e largimit, shefi i misionit përcillet në aeroport nga zyrtari i Protokollit të Shtetit. Në dispozicion të tij vihet salla VIP e aeroportit.

3. Fillimi i detyrës së diplomatit, atasheut ushtarak, konsullit dhe funksionarit të organizatave ndërkombëtare

3.1 Fillimi i detyrës së diplomatit, konsullit, funksionarit të organizatave ndërkombëtare njoftohet nga misioni përkatës me notë verbale drejtuar Drejtorisë së Protokollit të Shtetit, në të cilën shënohet në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike e vitit 1961 dhe Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore e vitit 1963.

3.2 Akreditimi i atasheut ushtarak ndjek të njëjtën procedurë për sa i përket kërkesës së agrementit, ndërsa konsultimet bëhen me strukturat përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes.

3.3 Organizatat ndërkombëtare që gëzojnë status diplomatik në Republikën e Shqipërisë duhet të bëjnë të njohur funksionarët e tyre të kategorisë së parë në të njëjtën mënyrë, si edhe misionet diplomatike, duke plotësuar të njëjtat procedura.

4. Konsujt e nderit të emëruar në Shqipëri

4.1 Konsujt e nderit e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963, si dhe me udhëzimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

4.2 Konsujt e nderit të emëruar në Shqipëri bëhen pjesë e veprimtarive protokollare sipas parashikimeve të këtij akti nënligjor.

5. Hapja e një përfaqësie të re diplomatike

5.1 Në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961, përfaqësuesi i shtetit dërgues i dorëzon notën verbale për hapjen e përfaqësisë Protokollit të Shtetit.

6. Pjesëmarrja e trupit diplomatik të akreditуar në Shqipëri në ceremonitë zyrtare

6.1 Trupi diplomatik ftohet ose mirëpritet të marrë pjesë në këto ceremoni kryesore zyrtare:

- hapja e sesionit të Kuvendit;
- seanca e Kuvendit, ku Kryeministri parashtron programin e qeverisë apo edhe në seanca të veçanta si ato mbi votëbesimin e qeverisë apo kur diskutohen tematika që lidhen me bashkëpunimin e Shqipërisë me vendin/organizatën përkatëse;
- seanca e Kuvendit, ku bëhet votimi për zgjedhjen e Presidentit të Republikës;
- ceremonia që zhvillohet me rastin e ndërrimit të mandatit të presidentëve; Dita e Dëshmorëve;
- Dita e Pavarësisë;
- pritja me rastin e Festës Kombëtare;
- parada ushtarake;
- pritja me rastin e Vitit të Ri;
- në aktivitetet vjetore që planifikon Ministria e Punëve të Jashtme;
- në funeralet shtetërore dhe në funeralet zyrtare.

7. Imuniteti diplomatik

7.1 Mbështetur në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961 dhe Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963, Protokolli i Shtetit respekton imunitetin diplomatik të trupit diplomatik të akreditуar në vendin tonë.

7.2 Imuniteti ndryshon në varësi të statusit të punonjësit diplomatik. Imunitet të plotë gëzojnë vetëm bartësit e kartës diplomatike të qëndrimit. Për ata që janë shtetas shqiptarë ose kanë dyshtetësi, të huaj dhe shqiptare, apo që kanë leje qëndrimi të përhershme, imuniteti shtrihet vetëm në fushën e ushtrimit të detyrës specifike që u është ngarkuar, por jo në të gjithë aktivitetin dhe aspektet e tjera të punës dhe jetës së tyre.

7.3 Çdo çështje konkrete që lind në një përfaqësi të caktuar apo nga një diplomat e cila duhet të trajtohet nga organet e administratës shtetërore qendrore apo vendore të shtetit shqiptar i njoftohet me shkrim Drejtorisë së Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

KAPITULLI III
SIMBOLET E REPUBLIKËS

Simbolet kryesore përfaqësuese të Republikës së Shqipërisë janë flamuri kombëtar dhe himni kombëtar, ndërsa stema e Republikës është simbol i shtetit. Përdorimi i simboleve në Shqipëri rregullohet me anë të ligjit nr. 8926, datë 22.7.2002, "Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës të Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre".

1. Flamuri kombëtar

1.1 Flamuri kombëtar përdoret në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8926, datë 22.7.2002, "Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës të Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre" dhe akteve nënligjore të dala në varësi të këtij ligji.

1.2 Kur flamuri shqiptar shpaloset bashkë me ndonjë flamur tjetër, qëndron gjithmonë në vendin e nderit, në të djathtë. Flamuri tjetër ose të tjerët, vendosen në të majtë të tij, me të njëjtat përmasa dhe lartësi shtizë.

1.3 Në takime ndërkombëtare shumëpalëshe flamurët e vendeve të huaja vendosen në të majtë të flamurit shqiptar dhe radha e tyre përcaktohet sipas rendit alfabetik.

1.4 Kur flamuri vendoset mbi rrugë ose në pozicione të tjera pa shtizën përkatëse, duhet të jetë kurdoherë me shqiponjën vertikalisht.

1.5 Gjatë ceremonisë së uljes ose ngritjes së flamurit, apo parakalimit të tij në revistë, të gjithë njerëzit prezent janë të detyruar të heqin kapelat dhe të marrin drejtqëndrim, duke ndjekur me shikim lëvizjen e flamurit.

1.6 Ushtarakët nderojnë ushtarakisht të drejtuar nga flamuri. Kur flamuri nuk duket, drejtqëndrimi mbahet nga banda. Të huajt prezent marrin drejtqëndrim.

1.7 Vendosja në zyrat publike e një ose më shumë flamurëve të huaj krahas flamurit shqiptar bëhet vetëm në rastet e ceremonive zyrtare ose takimeve dy- dhe shumëpalëshe me delegacione të huaja të nivelit ministër dhe në raste kur nënshkruhen marrëveshje zyrtare.

1.8 Në ditë zije, flamuri kombëtar ngrihet në gjysmështizë dhe i lidhet në pjesën e sipërme një fjongo e zezë, e cila qëndron e varur. Në rast zije për shkak të detyrës, flamurit i lidhet një fjongo kuqezi.

1.9 Kur flamuri vendoset në gjysmështizë, ai ngrihet deri në majë, qëndron pak çaste dhe pastaj zbritet në pozicionin gjysmështizë. Nëse në perëndim të diellit flamuri do të ulet, atëherë ai çohet përsëri deri në majë të shtizës dhe pastaj ulet.

1.10 Në ceremonitë funebre, në rastet kur flamuri përdoret për të mbuluar arkivolin, ai vendoset në pozicionin që shqiponja të bjerë në gjoksin e të ndjerit. Nuk lejohet që flamuri të futet në varr apo të takojë tokën gjatë ceremonisë funebre.

1.11 Flamuri i mbajtur në dorë nga trupat ushtarake nuk vendoset asnjëherë në gjysmështizë.

1.12 Flamujt dallues të armëve dhe të autoriteteve që kanë në varësi trupa ushtarake të Ministrisë së Mbrojtjes kanë në fundin e tyre një shirit me ngjyrë tjetër.

1.13 Kryetarët e bashkive, në ushtrimin e detyrës së tyre, gjatë ceremonive zyrtare vendosin shenjën dalluese të brezit kuqezi. Ky brez mbahet në ceremonitë zyrtare, pritjen e autoriteteve të larta, manifestimet e popullit në sheshin e qytetit, mbledhjet e këshillit ose të punës, festa, funerale dhe ngjarje të tjera publike. Brezi kuqezi vishet krahaqafë në shpatullën e djathtë.

1.14 Ngritja e flamurit dallues apo vendosja e shenjave të tjera të këtij karakteri bëhet vetëm në zyrat, selitë, ndërtesat dhe territoret e përcaktuara ku shtrihet juridiksioni i institucionit dhe kurdoherë në të majtë të flamurit kombëtar.

2. Himni kombëtar

2.1 Himni kombëtar shqiptar titullohet "Rreth flamurit të përbashkuar" dhe ekzekutohet kurdoherë në prezencën e flamurit kombëtar. Çdo shqiptar ka të drejtë të këndojë himnin kombëtar.

2.2 Himni kombëtar ekzekutohet në ceremonitë zyrtare dhe në raste të tjera të parashikuara nga rregulloret përkatëse ushtarake. Zyrtarisht interpretohet vetëm strofa e parë dhe refreni.

2.3 Vizita zyrtare e një Presidenti ose Kryeministri të huaj shoqërohet me ekzekutimin e himneve kombëtare të të dyja vendeve. Himni shqiptar interpretohet pas himnit mik.

2.4 Gjatë ekzekutimit të himnit kombëtar repartet ushtarake mbajnë drejtqëndrim ose, sipas rastit, për nder armë. Ushtarakët nderojnë ushtarakisht të drejtuar nga flamuri, kurse autoritetet civile dhe të gjithë sa janë të pranishëm ngrihen në këmbë dhe mbajnë drejtqëndrim. Nuk është e ndaluar që gjatë gjithë kohës së interpretimit të vendoset dora e djathtë në zemër, si shenjë e një nderimi më të veçantë për himnin dhe flamurin.

3. Stema e Republikës

3.1 Përdorimi i stemës së Republikës është e drejtë ekskluzive e organeve shtetërore. Stema e Republikës përdoret në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8926, datë 22.7.2002, "Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës të Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre" dhe akteve nënligjore të dala në varësi të këtij ligji. Strukturat përgjegjëse të administratës shtetërore marrin të gjitha masat për respektimin e detyrimeve ligjore të parashikuara për përdorimin e stemës së Republikës.

4. Portreti i themeluesit të shtetit modern shqiptar

4.1 Në zyrat e administratës publike, duke filluar nga niveli drejtor drejtorie deri te titullarët e institucionit, dhe në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, është e detyrueshme të vendoset portreti i themeluesit të shtetit modern shqiptar, Ismail Qemali.

KAPITULLI IV
CEREMONIALI I AUTORITETEVE MË TË LARTA TË SHTETIT

1. Rregulla të përgjithshme

1.1 Rangjet e Presidentit të Republikës, kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme, për shkak të funksioneve që kanë, rolit që luajnë dhe përgjegjësive që mbulojnë, dallohen në radhën e përparësisë dhe të privilegjeve ceremoniale.

1.2 Pas marrjes së detyrës e deri në fund të mandatit, Presidenti i Republikës, kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme gëzojnë, në komunikimin diplomatik, trajtesën e "Shkëlqesisë së tij". Në komunikimin administrativ dhe institucional brenda vendit rekomandohet një trajtesë e thjeshtësuar sipas formulës "Zoti..." ndjekur nga emri i funksionit.

1.3 Ceremonitë ku marrin pjesë këto autoritete organizohen sipas specifikave të aktivitetit nga Protokolli i Shtetit, nga zyrat e protokollit të brendshëm të tyre, nga institucione të ndryshme, ministri, organe vendore etj.

1.4 Organizatorët kanë për detyrë të njoftojnë Protokollin e Shtetit (kur në ceremoni marrin pjesë edhe personalitete të huaja), të paktën 2 (dy) javë para datës së caktuar dhe të informojnë për qëllimin, programin e plotë të aktivitetit, mënyrën e organizimit, masat e marra, listën e të ftuarve, kohën dhe vendin e caktuar.

1.5 Personaliteti i lartë i ftuar pritet nga titullari përkatës ministër, prefekt, kryetar bashkie dhe zyrtarët më të lartë në rang të institucionit përkatës. Titullari pritës i uron mirëseardhjen dhe i prezanton zyrtarët që e shoqërojnë.

1.6 Si rregull, Presidenti i Republikës, kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri, si personalitetet më të larta të shtetit, nuk marrin pjesë në të njëjtin aktivitet. Bëjnë përjashtim rastet emergjente, ngjarje të rëndësisë së veçantë apo ngjarje të shënuara, si festa kombëtare, funerale shteti etj.

1.7 Gjatë ecjes së parashikuar në ceremonitë zyrtare apo në presidiume takimesh, vendi i personalitetit më të lartë në rang është në radhën e parë në mes të atyre që e shoqërojnë. Numri i tyre duhet të jetë tek. Në të djathtë të personalitetit qëndron shoqëruesi më i lartë në rang.

1.8 Nëse ecja bëhet drejt një tribune folëse, personaliteti i lartë shoqërohet nga tri veta. Në momentin e mbërritjes te tribuna, shoqëruesit ndahen prej tij dhe qëndrojnë në vendet e tyre, të caktuara që më parë. Vendosja në tribunë bëhet sipas përparësisë zyrtare të pjesëmarrësve. Personaliteti vjen i fundit dhe largohet i pari.

1.9 Presidenti i Republikës, kryetari i Kuvendit, Kryeministri, ministri i Punëve të Jashtme dhe çdo autoritet tjetër në Republikën e Shqipërisë respektojnë një ceremonial të barabartë kundrejt përfaqësuesve të lartë klerikë.

1.10 Kur konsiderohet e nevojshme ose për arsye shtetërore, personalitetet e mësipërme mund të bëjnë lëvizje preferenciale në radhën e klerikëve, duke mbajtur më pranë apo duke dalluar klerikun që lidhet me veçoritë ceremoniale të momentit. Në çdo rast tjetër, më afër qëndron kleriku më i lartë në rang në fenë respektive.

1.11 Personalitetet e mësipërme presin dhe takojnë me kërkesën e tyre individë të ndryshëm, diplomatë, zyrtarë të niveleve të ndryshme dhe njerëz të thjeshtë sipas një rregulli të përcaktuar nga vetë institucioni.

1.12 Protokolli i Shtetit koordinon për aspektet dhe procedurat protokollare të organizimit të vizitave të Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme në bashkëpunim me kabinetet përkatëse.

1.13 Ceremonia e pritjes së homologut të huaj bëhet në selinë e personalitetit të lartë ose në një rezidencë tjetër qeveritare.

2. Presidenti i Republikës

2.1 Presidenti i Republikës është kryetar i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit. Ushtrimi i mandatit të tij shoqërohet gjatë gjithë periudhës nga një ceremonial i veçantë për të gjitha aspektet zyrtare dhe jozyrtare të jetës dhe aktivitetit të tij.

2.2 Bashkëshortja e Presidentit gëzon titullin e zonjës së parë të vendit. Ajo është personalitet publik dhe gëzon një trajtim të veçantë. Bashkëshortes së Presidentit gjithkush i drejtohet "Zonja... (vijon mbiemri)".

2.3 Bashkëshortja e Presidentit e shoqëron bashkëshortin në vizitat që kryen, merr pjesë, sipas dëshirës, në aktivitetet dhe ceremonitë që zhvillohen, por jo në takimet zyrtare. Gjatë këtyre aktiviteteve ajo gëzon të drejtën e një programi të veçantë protokollar.

2.4 Në pritje të ndryshme dhe festa kombëtare që jepen nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në Shqipëri, Presidenti i Republikës merr pjesë vetëm në rastet kur e konsideron të arsyeshme dhe shumë të rëndësishme praninë e tij.

3. Ceremonia e fillimit të detyrës së Presidentit të Republikës

3.1 Ceremonia e fillimit të detyrës së Presidentit të Republikës zhvillohet si një e tërë, e ndarë në dy momente kryesore, në sallën e Kuvendit dhe në selinë e institucionit të Presidentit të Republikës ose Pallatin e Brigadave.

3.2 Ditën e caktuar në seancën e Kuvendit të Shqipërisë, përveç deputetëve, mund të marrin pjesë edhe të ftuar të tjerë të huaj dhe titullarët e përfaqësive diplomatike. Protokolli i Kuvendit drejton ceremoninë në sallën e Kuvendit.

3.3 Presidenti në detyrë, me familjen e tij, zë vend në lozhën nr. 1, kurse në atë ngjitur vendoset familja e Presidentit të zgjedhur.

3.4 Në orën 18:00, Presidenti i Republikës mbërrin në hyrjen kryesore të Kuvendit dhe, po në këtë moment, del aty për ta pritur kryetari i Kuvendit. Mbasi përshëndeten, të dy personalitetet hyjnë në sallën e Kuvendit dhe zënë vend në podium.

3.5 Kryetari i Kuvendit fton Presidentin të ngrihet në këmbë për të bërë betimin, ndërkohë të gjithë të pranishmit janë të ulur nëpër vendet e tyre. Kryetari i Kuvendit lexon formulën e betimit, sipas Kushtetutës, neni 88, pika 3. Presidenti deklaron: "Betohem!".

3.6 Mbas betimit ekzekutohet himni kombëtar i Shqipërisë. Gjatë ekzekutimit të himnit të gjithë të pranishmit në sallë ngrihen në këmbë. Kryetari i Kuvendit fton Presidentin për të marrë fjalën përshëndetëse para Kuvendit. Presidenti mban fjalën.

3.7 Kryetari i Kuvendit uron Presidentin për detyrën dhe deklaron mbylljen e seancës plenare, duke kërkuar leje për të shoqëruar Presidentin deri në hyrjen kryesore. Të gjithë të pranishmit ngrihen më këmbë.

3.8 Mbas Kuvendit të Shqipërisë, ceremonia presidenciale vijon në selinë e institucionit të Presidentit të Republikës ose Pallatin e Brigadave. Të ftuarit mbërrijnë deri në orën 19:15 dhe, nën drejtimin e Protokollit të Shtetit, zënë vendet e caktuara për ta. Tribuna A, rezervohet për miqtë e huaj dhe titullarët e përfaqësive diplomatike, kurse tribuna B, për personalitetet e larta shtetërore dhe miqtë vendës.

3.9 Në orën 19:25 mbërrin dhe zë vend në krye të shkallëve ish-Presidenti i Republikës.

3.10 Në orën 19:30 mbërrin Presidenti i Republikës, makina e të cilit shoqërohet nga truproja e nderit në gjashtë motoçikleta ceremoniale.

3.11 Mbas mbërritjes së Presidentit të Republikës, zhvillohet ceremonia e nderit sipas skemës përkatëse të miratuar nga Protokolli i Shtetit. Presidenti zë vend në krye të shkallëve, në të djathtë të ish-Presidentit. Në të dyja anët e shkallëve janë vendosur truproja të Gardës së Republikës me uniforma ceremoniale dhe të pajisur me shpata ceremoniale për nderim armë.

3.12 Ekzekutohet himni kombëtar, i cili shoqërohet me 21 të shtëna topi artilerie me interval 30 sekonda nga njëra-tjetra. Gjatë gjithë kohës, flamuri kombëtar qëndron i ngritur.

3.13 Drejtori i Protokollit të Shtetit fton kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, që, në mënyrë simbolike, t'i dorëzojë Presidentit të zgjedhur, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Gjatë dorëzimit, kryetari i Gjykatës Kushtetuese deklaron: "I nderuar Zoti President, kam nderin t'ju dorëzoj Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë". Gjatë kësaj ceremonie, një përfaqësues i titullarëve të urdhrave dhe dekoratave kombëtare, i dorëzon Presidentit simbolin përkatës.

3.14 Drejtori i Protokollit të Shtetit fton Presidentin e zgjedhur të bëjë përshëndetjen e rastit.

3.15 Zhvillohet parakalimi tradicional i truprojës së nderit. Pas kësaj, të pranishmit ftohen në ambientet e brendshme për të marrë pjesë në pritjen zyrtare.

4. Institucioni i Presidentit të Republikës

4.1 Presidenti i Republikës dhe selia ku ai ushtron detyrat e tij kushtetuese gëzojnë një trajtim ceremonial të veçantë. Në hyrjen kryesore të selisë së institucionit të Presidentit të Republikës qëndrojnë në pozicion nderi dy truproja nderi me uniformë ceremoniale.

4.2 Para hyrjes së korridorit dhe në hyrje të zyrës së Presidentit qëndrojnë dy truproja nderi me uniformë ceremoniale.

4.3 Kur kalon Presidenti, të pranishmit ngrihen në këmbë dhe i përgjigjen përshëndetjes së tij. Presidentit gjithsecili i drejtohet "Z. President".

4.4 Presidenti i Republikës ka të drejtë të mbajë flamur dallues dhe stemë, simbole të kreut të shtetit, si shenjë e veçantë që identifikon shkallën e hierarkisë dhe autoritetin e këtij rangu. Në zyrën e Presidentit, mbrapa poltronit të tij qëndrojnë dy flamurë, në të djathtë flamuri kombëtar dhe në të majtë flamuri dallues i Presidentit.

4.5 Protokolli i brendshëm i Presidentit të Republikës drejtohet nga shefi i zyrës për protokollin e Presidentit. Ai është përgjegjës për takimet e përditshme që bëhen në zyrën e Presidentit, lëvizjet dhe aktivitetet brenda territorit të Shqipërisë, në përputhje me ceremonialin shtetëror.

4.6 Në kuadrin e aktivitetit të tij të përditshëm zyrtar dhe protokollar, Presidentit të Republikës i atashohet, me kërkesë të tij, një oficer ordinance i një grade jo më të ulët se nën/kolonel. Arma (forca tokësore, detare, ajrore, Garda e Republikës) dhe personi në shërbim të Presidentit përzgjidhen personalisht prej tij.

Oficeri i ordinancës, nën autoritetin e shefit të zyrës së protokollit, e shoqëron Presidentin në çdo aktivitet protokollar, i veshur me uniformën e armës së tij. Në krahun e djathtë të uniformës vendoset kordelja që tregon cilësinë e oficerit të ordinancës të kreut të shtetit.

4.7 Në vizitat zyrtare brenda vendit, kabineti i Presidentit të Republikës përcakton personat që do ta shoqërojnë atë sipas qëllimit të vizitës.

4.8 Nëse Presidenti i Republikës dëshiron të shoqërohet nga anëtarë të Këshillit të Ministrave, kjo realizohet nëpërmjet konsultimit të kabinetit të Presidentit me kabinetin e Kryeministrit.

4.9 Presidenti i Republikës jep sipas rastit pritje, dreka dhe darka shteti. Vendosja e të ftuarve bëhet sipas protokollit përkatës.

4.10 Rangu i Presidentit nuk është i delegueshëm. Në rastet kur Presidenti nuk merr pjesë vetë por dërgon një përfaqësues, ky i fundit nuk gëzon nderimin që do t'i bëhej vetë Presidentit. Përfaqësuesi i Presidentit radhitet në vendin që i takon sipas rangut të tij.

4.11 Kur Presidenti i Republikës bën vizitë jashtë kryeqytetit, pritet në kufi të qarkut nga prefekti dhe autoritete të tjera vendore, të cilët e shoqërojnë gjatë vizitës brenda territorit që kanë nën juridiksion. Kur arrin në qytet, Presidenti i Republikës pritet nga kryetari i bashkisë. Personalitetet publike të vendit ftohen në një takim të përbashkët me kreun e shtetit. I njëjti nderim i bëhet edhe gjatë largimit. E njëjta ceremoni zhvillohet edhe kur vizitën e bën zyrtarisht një President i huaj.

4.12 Në rastin kur Presidenti i Republikës udhëton jashtë shtetit, si rregull përcillet nga shefi i zyrës së protokollit të Presidentit.

4.13 Për pritjen dhe përcjelljen e Presidentit të Republikës shtrohet tapeti i kuq në hyrje të sallës VIP të aeroportit ku janë të pranishëm edhe 2 (dy) truproja nderi. Në rastet e vizitave zyrtare ose shtetërore, kur kërkohet nga protokolli i Presidencës, tapeti i kuq shtrohet edhe në hyrje të avionit ku vendosen edhe truprojat e nderit (9+2).

Protokolli i Presidencës kryen të gjitha formalitetet dokumentare të nevojshme para largimit dhe për ardhjen e Tij. Shoqërimi i Presidentit të Republikës në këtë rast nga Protokolli i Shtetit bëhet sipas përcaktimeve të kapitullit V, pika 7.2, të këtij akti.

5. Pritje në selinë e institucionit të Presidentit të Republikës

5.1 Në rastin e vizitës së një kryetari shteti, qeverie ose vizitor tjetër i lartë, Presidenti i Republikës e pret atë në selinë e institucionit të Presidentit të Republikës ose në një rezidencë tjetër qeveritare.

5.2 Nëse vizitori është kryetar shteti në vizitë shtetërore zyrtare, organizohet për nder të tij ceremonia e nderit në selinë e institucionit të Presidentit të Republikës ose rezidencë tjetër qeveritare, sipas skemës së miratuar.

5.3 Dy orë para mbërritjes së kreut të shtetit mik, në vendin e caktuar ngrihet flamuri i tij kombëtar në krah të majtë të flamurit shqiptar. Flamuj të të dyja vendeve vendosen në stativë në përmasat e përcaktuara në ceremonialin shtetëror në sallën e takimit ose me përmasa të vogla në tavolinën e bisedimeve zyrtare.

5.4. Nëse kreu i shtetit mik nuk është në vizitë shtetërore (kalimtare, private, shumëpalëshe), atëherë nuk zhvillohet ceremoni nderi. Vizitori i huaj nderohet në hyrje nga truproja e nderit. Edhe përcjellja bëhet në të njëjtën mënyrë si pritja.

6. Kuvendi

6.1 Kuvendi është organi legjislativ i Republikës së Shqipërisë. Si i tillë ai gëzon të drejtën e një ceremoniali të veçantë në aktivitetin e tij zyrtar. Kompetencat për trajtimin dhe për zbatimin e këtij ceremoniali i ka zyra e protokollit të Kuvendit.

6.2 Kryetari i Kuvendit dhe selia ku ai ushtron detyrat e tij kushtetuese gëzojnë një trajtim ceremonial të veçantë. Dy truproja ceremoniale qëndrojnë në hyrje të zyrës së kryetarit apo të sallave ku ai zhvillon takimet zyrtare, sa herë që zyra e Protokollit të Kuvendit e gjen të përshtatshme dhe të nevojshme.

6.3 Protokolli i Kuvendit drejton ceremonialin në Kuvend. Detyrat e tij parashikohen në rregulloren e brendshme të Kuvendit.

6.4 Protokolli i Kuvendit organizon, ndjek dhe programon ceremonitë e pritjes e të përcjelljes, si dhe të gjitha praktikat protokollare gjatë vizitave të delegacioneve të huaja të institucioneve parlamentare ndërkombëtare.

6.5 Protokolli i Shtetit koordinon në bashkëpunim me protokollin e Kuvendit takimet e kryetarit të Kuvendit me delegacionet e nivelit President, Kryeministër, ministër të Punëve të Jashtme që vizitojnë vendin tonë dhe të ambasadorëve të rinj që paraqesin letër kredencialet. Takimet e tjera koordinohen nga zyra e protokollit të Kuvendit.

6.6 Protokolli i Kuvendit informon Ministrinë e Punëve të Jashtme nëpërmjet Protokollit të Shtetit për ftesat dhe telegramet zyrtare që kryetari i Kuvendit dërgon për homologë dhe titullarë të organizatave e institucioneve të ndryshme ndërkombëtare.

6.7 Protokolli i Kuvendit ndjek praktikat diplomatike me përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë për vizitat e delegacioneve të Kuvendit, për dërgim të ftesave dhe të telegrameve të urimit dhe harton listën e pjesëmarrësve në takimet zyrtare dhe pritjet e kryetarit të Kuvendit.

6.8 Ceremonitë e ndryshme protokollare, që zhvillohen në sallën plenare të Kuvendit, janë objekt dhe kompetencë e zyrës së protokollit të Kuvendit.

6.9 Për pritjen dhe përcjelljen e kryetarit të Kuvendit shtrohet tapeti i kuq në hyrjen e sallës VIP të aeroportit dhe janë të pranishëm edhe 2 (dy) truproja nderi. Në rastet e vizitave zyrtare, kur kërkohet nga protokolli i Kuvendit, tapeti i kuq shtrohet edhe në hyrje të avionit ku vendosen edhe truprojat e nderit (7+2).

7. Kryetari i Kuvendit

7.1 Kryetari i Kuvendit si rangu më i lartë i pushtetit legjislativ në Republikën e Shqipërisë ka të drejtën e një ceremoniali të veçantë në të gjitha aspektet zyrtare dhe jozyrtare të jetës dhe aktivitetit të tij. Gjithkush i drejtohet atij "z. Kryetar i Kuvendit".

7.2 Bashkëshortja e kryetarit të Kuvendit është personalitet publik dhe gëzon një trajtim të veçantë. Bashkëshortes së kryetarit të Kuvendit gjithsecili i drejtohet "Zonja... (vijon mbiemri)".

7.3 Bashkëshortja e kryetarit të Kuvendit e shoqëron bashkëshortin në vizitat që kryen, merr pjesë, sipas dëshirës, në aktivitetet dhe ceremonitë që zhvillohen, por jo në takimet zyrtare. Gjatë këtyre aktiviteteve ajo gëzon të drejtën e një programi të veçantë protokollar.

8. Kryeministri

8.1 Kryeministri, si rangu më i lartë i pushtetit ekzekutiv në Shqipëri ka të drejtën e një ceremoniali të veçantë në të gjitha aspektet zyrtare dhe jozyrtare të jetës dhe aktivitetit të tij. Kryeministrit gjithsecili i drejtohet, "Z. Kryeministër".

8.2 Bashkëshortja e Kryeministrit është personalitet publik dhe gëzon një trajtim të veçantë. Bashkëshortes së Kryeministrit gjithsecili i drejtohet "Zonja... (vijon mbiemri)".

8.3 Bashkëshortja e Kryeministrit e shoqëron bashkëshortin në vizitat që kryen, merr pjesë, sipas dëshirës, në aktivitetet dhe ceremonitë që zhvillohen, por jo në takimet zyrtare. Gjatë këtyre aktiviteteve ajo gëzon të drejtën e një programi të veçantë protokollar.

9. Betimi i qeverisë

9.1 Ceremonia e betimit të qeverisë së sapo zgjedhur zhvillohet në selinë e institucionit të Presidentit të Republikës. Në të marrin pjesë, gjithashtu, të ftuar nga institucionet kryesore të shtetit, përfaqësues të klerit, dekani i trupit diplomatik. Listën e të ftuarve e përpilon zyra e Presidentit në përputhje të plotë me Ceremonialin dhe radhën e përparësisë në Republikën e Shqipërisë. Protokolli i Shtetit bashkërendon mbarëvajtjen e ceremonisë.

9.2 Qeveria, e kryesuar nga Kryeministri, ulet në vendin e caktuar sipas renditjes në listën qeveritare. Ceremoninë e hap Sekretari i Përgjithshëm i institucionit të Presidentit të Republikës. Hyn Presidenti i Republikës dhe zë vendin e caktuar pranë flamurit. Të gjithë të pranishmit ngrihen në këmbë. Fillon ekzekutimi i himnit kombëtar.

9.3 Sekretari i Përgjithshëm lexon formulën e betimit. Kryeministri afrohet në vendin e caktuar, vë dorën mbi Kushtetutën e Republikës dhe thotë me zë të lartë "Betohem!". Pastaj ulet dhe firmos dokumentin e betimit, shtrëngon dorën me Presidentin e Republikës dhe kthehet në vendin e tij. Të njëjtën procedurë e përsërisin të gjithë anëtarët e qeverisë sipas radhës.

9.4 Në mbarim të betimit, Sekretari i Përgjithshëm fton të pranishmit të ulen dhe i jep fjalën Presidentit të Republikës, i cili përshëndet Kryeministrin dhe anëtarët e qeverisë.

9.5 Pas fjalës, Presidenti fton Kryeministrin dhe anëtarët e tjerë të qeverisë për një fotografi të përbashkët. Më pas, Presidenti fton Kryeministrin në zyrën e tij për një bisedë të shkurtër. Të pranishmit fillojnë të largohen nga mjediset e Presidencës të përcjellë nga stafi i Presidentit.

9.6 Pas betimit, qeveria mblidhet në selinë e Kryeministrisë në takimin e parë përurues dhe Kryeministri përshëndet çdo ministër për fillimin me sukses të detyrës.

9.7 Lista e qeverisë dhe CV-të e anëtarëve të saj shpërndahen në të gjitha prefekturat e vendit, përfaqësitë diplomatike shqiptare të akredituara jashtë vendit dhe përfaqësitë e huaja diplomatike të akredituara në Shqipëri.

9.8 Me rastin e fillimit të detyrës, Kryeministri mund të japë në një nga rezidencat qeveritare një pritje për trupin diplomatik. Ftohen të gjithë shefat e përfaqësive të akredituara në Shqipëri dhe personalitete të tjera. Lista hartohet nga zyra e Kryeministrit, në pajtim me radhën e përparësisë së Republikës. Organizimi i ceremonisë bashkërendohet nga Protokolli i Shtetit.

10. Kryeministria

10.1 Kryeministri dhe selia ku ai ushtron detyrat e tij kushtetuese gëzojnë një trajtim ceremonial të veçantë. Dy truproja ceremoniale qëndrojnë në hyrjet veriore dhe perëndimore të godinës së Kryeministrisë, si dhe në hyrje të zyrës së Kryeministrit apo të sallave ku ai zhvillon takimet zyrtare, sa herë që zyra e Protokollit të Kryeministrit e gjen të përshtatshme dhe të nevojshme.

10.2 Rangu i Kryeministrit ka të drejtë të mbajë flamur dallues si shenjë e veçantë që identifikon shkallën e hierarkisë dhe autoritetin e këtij rangu për të drejtuar e komanduar. Në zyrën e Kryeministrit, mbrapa poltronës së tij qëndrojnë dy flamurë, në të djathtë flamuri kombëtar dhe në të majtë flamuri dallues i Kryeministrit.

10.3 Zyra e Protokollit të Kryeministrit drejtohet nga shefi i kësaj zyre. Ai është përgjegjës për pritjet dhe përcjelljet që bëhen në zyrën e Kryeministrit, lëvizjet dhe aktivitetet që bëhen brenda territorit të Shqipërisë, në përputhje me ceremonialin shtetëror.

10.4 Në kuadrin e aktivitetit të tij të përditshëm zyrtar dhe protokollar, Kryeministrit i atashohet, me kërkesë të tij, një oficer ordinance i një grade jo më të ulët se nën/kolonel. Arma (forca tokësore, detare, ajrore, Garda e Republikës) dhe personi në shërbim të Kryeministrit përzgjidhen personalisht prej tij.

Oficeri i ordinancës, nën autoritetin e drejtuesit të protokollit të veçantë, e shoqëron Kryeministrin në çdo aktivitet protokollar, i veshur me uniformën e armës së tij. Në krahun e djathtë të uniformës vendoset kordelja që tregon cilësinë e oficerit të ordinancës të Kryeministrit.

10.5 Rangu protokollar i Kryeministrit është i delegueshëm. Nëse Kryeministri është i ftuar në aktivitete publike të çfarëdo lloji dhe nuk merr pjesë vetë por dërgon zëvendëskryeministrin ose një

ministër si përfaqësues, ky i fundit gëzon nderimin që do t'i bëhej vetë Kryeministrit. Kjo nuk zbatohet për përfaqësuesit e pozicioneve të tjera qeveritare.

10.6 Në rastin kur Kryeministri udhëton jashtë shtetit, përcillet nga shefi i Zyrës së Protokollit të Kryeministrit.

10.7 Për pritjen dhe përcjelljen e Kryeministrit shtrohet tapeti i kuq në hyrjen e sallës VIP të aeroportit dhe janë të pranishëm edhe 2 (dy) truproja nderi. Në rastet e vizitave zyrtare, kur kërkohet nga protokolli i Kryeministrit, tapeti i kuq shtrohet edhe në hyrje të avionit ku vendosen edhe truprojat e nderit (7+2).

10.8 Protokolli i Kryeministrit kryen të gjitha formalitetet dokumentare të nevojshme para largimit dhe për ardhjen e tij. Shoqërimi i Kryeministrit në këtë rast nga Protokolli i Shtetit bëhet sipas përcaktimit të kapitullit V, pika 7.2, e këtij akti.

11. Pritje në Kryeministri

11.1 Në selinë e tij, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë pret dhe përcjell vizitorë sipas një programi të miratuar që më parë. Ceremonitë zyrtare me vizitorë të huaj drejtohen nga Protokolli i Shtetit në bashkërendim me shefin e Zyrës së Protokollit të Kryeministrit.

11.2 Dy orë para mbërritjes, ngrihet në seli flamuri i shtetit mik, në krah të majtë të flamurit shqiptar. Flamurë të të dyja vendeve vendosen në sallën e takimit ose me përmasa të vogla, në tavolinën e bisedimeve zyrtare.

11.3 Në vizitat zyrtare zhvillohet ceremonia e nderit. Ajo zhvillohet para Kryeministrisë ose në një rezidencë tjetër qeveritare sipas skemës së përcaktuar.

11.4 Në vizita jozyrtare (kalimtare, private dhe shumëpalëshe) nuk zhvillohet ceremonia e nderit.

11.5 Si rregull, çdo fund viti, Kryeministri organizon një takim pune me të gjithë trupin diplomatik. Në këtë takim, i cili mbyllet nga një koktej, Kryeministri shoqërohet nga ministri i Punëve të Jashtme. Takimi çelet nga ministri i Punëve të Jashtme, i ndjekur nga fjala e dekanit të trupit diplomatik. I fundit e merr fjalën Kryeministri.

12. Ministria e Punëve të Jashtme

12.1 Ministria e Punëve të Jashtme organizon me trupin diplomatik pritje të ndryshme duke përfshirë në to, sipas rastit, edhe personalitete publike shqiptare apo të huaj.

12.2 Ministri i Punëve të Jashtme, së bashku me bashkëshorten organizon pritje, dreka apo darka, si dhe aktivitete diplomatike, sipas momentit dhe qëllimeve që kërkon të realizojë nëpërmjet tyre. Kjo përcaktohet në përputhje me synimet politike që ai vetë ka miratuar.

12.3 Pritja e parë e ministrit të Punëve të Jashtme jepet sapo fillon detyrën zyrtare. Pritja jepet brenda orarit zyrtar, vetëm për shefat e përfaqësive diplomatike ose jashtë orarit zyrtar, nëse ftohen bashkë me bashkëshortet.

12.4 Ministri i Punëve të Jashtme ftohet të marrë pjesë në drekat ose darkat shtetërore dhe zyrtare që shtron Presidenti i Republikës për homologët e tij ose miq të tjerë të lartë.

12.5 Ministria e Punëve të Jashtme ndjek me kujdes të gjitha aktivitetet e përfaqësive diplomatike në Tiranë dhe respekton karakterin dhe qëllimin për të cilin ato zhvillohen.

KAPITULLI V
VIZITA DHE TAKIME

(Shtuar togfjalësh në nënpikën 2.3 të pikës 2 me VKM nr. 573, datë 6.10.2021)

Ceremoniali i Republikës së Shqipërisë parashikon këto lloj vizitash:

- shtetërore (vetëm nga kryetarë shteti);
- zyrtare;
- pune;
- private.

Vizitat dhe takimet ndërkombëtare të kreut të shtetit, kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme në Republikën e Shqipërisë organizohen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Ftesat bëhen respektivisht nga Presidenti i Republikës, kryetari i Kuvendit, Kryeministri, ministri i Punëve të Jashtme, homologëve të tyre të huaj gjatë takimeve që mund të kenë me ta ose edhe zyrtarisht, nëpërmjet përfaqësuesve diplomatikë. Ftesat e Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme dërgohen nëpërmjet Protokollit të Shtetit. Protokolli i Kuvendit informon Ministrinë e Punëve të Jashtme nëpërmjet Protokollit të Shtetit për ftesat që kryetari Kuvendit dërgon për homologët e tij. Palët bien dakord nëpërmjet kanaleve diplomatike për kohën e vizitës, si dhe për kohëzgjatjen e saj.

Kur kryetari i delegacionit është kryetar shteti, kryetar Parlamenti, Kryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme, në media jepet një biografi e shkurtër e jetës dhe e veprimtarisë së tij, e shoqëruar me një përmbledhje të shkurtër të historikut të marrëdhënieve midis dy vendeve.

Hartimi i programit bëhet duke bashkëpunuar ngushtë me përfaqësinë diplomatike të vendit nga vjen delegacioni. Në program përcaktohen imtësisht të gjitha detajet e nevojshme (mënyra e pritjes dhe e përcjelljes, përbërja e delegacioneve, takimet, zhvillimi dhe formati i bisedimeve etj.). Protokolli i Shtetit kujdeset posaçërisht për respektimin e aspekteve të veçanta e që paraqesin ndjeshmëri (aspekte të natyrës kulturore, fetare apo të karakterit personal) për vizitorin e lartë dhe delegacionin e tij. Përfaqësisë diplomatike i jepet një kopje e programit përfundimtar disa ditë përpara mbërritjes së delegacionit.

1. Pritja e delegacioneve të huaja të nivelit të lartë

1.1 Vizita shtetërore organizohet vetëm për kryetar shteti. Gjatë vizitës shtetërore zhvillohet gjithmonë ceremonia e plotë e pritjes me truprojën e nderit dhe ekzekutimin e himneve kombëtare. Vizitat shtetërore, bazuar edhe në parimin e reciprocitetit, mund të shoqërohen me 21 të shtëna topi dhe me zbukurim flamujsh të vendit mik dhe atij shqiptar.

1.2 Ceremonia e plotë e pritjes me truprojën e nderit dhe ekzekutimin e himneve kombëtare zhvillohet gjithmonë gjatë vizitave zyrtare në nivel Kryeministri.

1.3 Për vizitat zyrtare të caktuara, nderimet ushtarake mund të reduktohen në renditje të truprojës pa ekzekutimin e himnit kombëtar. Ecja e personalitetit shoqërohet nga një marsh i luajtur nga banda muzikore e ushtrisë.

1.4 Në rast vizite pune dhe private, në selinë e autoritetit shqiptar zhvillohet një ceremoni pritjeje me truprojë nderi të reduktuar, pa ekzekutim himni. Protokolli i Shtetit e shoqëron atë në takimin me autoritetin shqiptar.

1.5 Autoriteti mik dhe anëtarët e tjerë të delegacionit përshëndeten gjatë ceremonisë së nderit me autoritetet e vendit që kanë dalë për t'i pritur, si dhe me personelin e përfaqësisë diplomatike të vendit të tyre.

1.6 Në rast se personaliteti mik është kryetar shteti apo qeverie, drejtori i Protokollit të Shtetit ngjitet në avion për t'i uruar mirëseardhjen, i shoqëruar, nëse kjo gjë kërkohet paraprakisht nga kreu i përfaqësisë diplomatike i vendit mik.

1.7 Të parët vendosen në radhë personalitetet vendëse dhe më tej personeli i përfaqësisë diplomatike, si dhe të tjerë të miratuar paraprakisht nga protokolli sipas përparësisë zyrtare. Sugjerohet që numri i personaliteteve vendëse që marrin pjesë në ceremoni të jetë i kufizuar.

1.8 Personalitetet shqiptare prezantohen nga autoriteti shqiptar, kurse personeli diplomatik prezantohet nga ambasadori përkatës.

1.9 Ceremonia zyrtare me flamujt kombëtare të të dyja vendeve, truprojën e nderit dhe bandën muzikore zhvillohet vetëm në rastin kur kryetari i delegacionit është kryetar shteti dhe kryetar qeverie ose i rangut të barabartë me ta. Në pikat kufitare tokësore apo ato bregdetare nuk zhvillohet ceremoni zyrtare.

1.10 Në vizita shtetërore dhe zyrtare, makina e kryetarit të shtetit mik shoqërohet nga gjashtë motoçikleta ceremoniali dhe nga katër kur është kryetar Parlamenti ose Kryeministër. Në të djathtë të makinës VIP vendoset flamuri i vendit mik. Në raste vizitash pune, kortezie, private dhe takime shumëpalëshe, personaliteti i huaj nuk shoqërohet me motoçikleta.

1.11 Dy autoritetet homologe mund të hipin në të njëjtin automjet vetëm në rastet e parashikuara sipas programit. Autoriteti shqiptar e fton mikun të qëndrojë në krahun e tij të djathtë.

1.12 Kur delegacioni kryesohet nga ministri i Mbrojtjes, ceremonia zhvillohet në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes ose në repartin ushtarak të përcaktuar që më parë sipas programit.

1.13 Çdo kryetar shteti ose Kryeministër, që viziton Shqipërinë për më shumë se një ditë, mund të zhvillojë një takim kortezie me kryetarin e bashkisë së qytetit ku vendoset dhe e falënderon atë për mikpritjen. Kryetari i bashkisë i dhuron në shenjë simbolike çelësin e qytetit.

1.14 Për nder të delegacionit, homologu shqiptar jep drekë ose darkë zyrtare. Për delegacionin në nivel kryetar shteti, i cili qëndron vetëm një ditë, Presidenti shtron drekë shteti për të gjithë delegacionin. Në këtë rast, në drekë ftohet të marrë pjesë edhe Kryeministri. Nëse delegacioni qëndron dy ditë, Presidenti shtron darkë shteti dhe Kryeministri shtron drekë zyrtare.

1.15 Në fillim të drekës ose darkës zyrtare mbahen përshëndetje të shkurtra në formën e urimit nga të dy kryetarët e delegacioneve. Është mirë që fjalimi dhe përkthimi i tij të përgatiten disa ditë përpara dhe t'i bëhen të njohura mikut të ftuar nëpërmjet përfaqësisë diplomatike përkatëse, në mënyrë që ai të përgatisë përgjigjen dhe përkthimin në gjuhën shqipe.

1.16 Fjalimet mbahen në gjuhën kombëtare dhe secili pjesëmarrës në drekë ose darkë e ka përpara tekstin në gjuhën përkatëse. Gjatë drekës ose darkës zyrtare duhet të jetë i pranishëm një përkthyes.

1.17 Midis kryetarëve të delegacioneve shkëmbehen dhurata, si rregull, nëpërmjet protokolleve.

1.18 Midis krerëve të delegacioneve, kur bëhet fjalë për krerë shtetesh dhe qeverish, mund të ketë dekorim protokollar të ndërsjellë, nëse është miratuar më parë nga të dyja palët.

1.19 Kur kryetari i delegacionit është kryetar shteti në vizitë shtetërore dhe vizita e tij zgjat më tepër se një ditë, në program planifikohet vendosje e kurorës në emër të tij në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit. Në këto homazhe shoqërohet nga drejtori i Protokollit të Shtetit dhe pritet në vend nga kryetari i bashkisë ose zëvendësi dhe Komandanti i Gardës së Republikës. Përgatitjet e ceremonialit bëhen nga dekori i Bashkisë së Tiranës dhe kurora përgatitet nga ambasada përkatëse.

1.20 Kur kryetari i delegacionit është kryetar shteti në vizitë shtetërore ose Kryeministër në vizitë zyrtare në program mund të parashikohet një përshëndetje e tij në parlamentin shqiptar. Miku flet në gjuhën e zgjedhur prej tij. Protokolli i Kuvendit përgjigjet për përkthimin.

1.21 Flamuri i vendit mik vendoset në selinë e homologut shqiptar në të majtë të flamurit shqiptar. Gjatë kohës që miku i lartë qëndron në Shqipëri, në rezidencën ku ai vendoset ngrihet flamuri i tij kombëtar, i cili qëndron i shpalosur deri në largim.

1.22 Delegacioni i huaj, në vizitat që mund të bëjë në qytetet e tjera të Shqipërisë shoqërohet nga një personalitet i lartë i përcaktuar që më parë nga Protokolli i Shtetit në koordinim me institucionin mikpritës. Në këto raste delegacionit i uron mirëseardhjen prefekti, kryetari i bashkisë dhe autoritete të tjera të pushtetit vendor. Përcjellja e delegacionit bëhet në të njëjtën mënyrë dhe nga të njëjtët persona që e presin.

1.23 Kur kryetari i delegacionit shoqërohet nga bashkëshortja/bashkëshorti, një program i veçantë përgatitet për të dhe bashkëshorten/bashkëshortin e autoritetit shqiptar. Bashkëshortët përkatës asistojnë në pjesën ceremoniale të vizitës (pritje, përcjellje, drekë ose darkë zyrtare, vizita shoqërore, kulturore e humanitare etj.), por jo në bisedime dhe takime zyrtare.

1.24 Mediat vihen në dijeni paraprakisht për vizitën nga zyra e shtypit e institucionit që e organizon vizitën. Kjo zyrë organizon mbërritjen, lëvizjen, pjesëmarrjen dhe përcjelljen e grupit të gazetarëve që shoqërojnë personalitetin e huaj.

1.25 Programi i vizitës shtetërore apo zyrtare, listat e pjesëmarrësve në takimet e parashikuara dhe çdo veprimtari tjetër që përfshihet në program, miratohen paraprakisht nga autoriteti shqiptar pritës. Zbatimi i tij bëhet nga Protokolli i Shtetit. Ai mobilizon të gjitha strukturat e nevojshme shtetërore dhe i vendos në dispozicion të realizimit sa më të mirë të vizitës.

1.26 Nëse takimi i lartë është tre- ose shumëpalësh, ajo konsiderohet vizitë pune. Në këtë rast nuk zhvillohet ceremoni e plotë nderi. Miqtë e huaj priten me truprojë nderi të reduktuar pa bandë muzikore (14 truproja). Pritja në aeroport bëhet nga drejtori i Protokollit të Shtetit ose shefi i Ceremonialit dhe sipas rastit nga zyrtarë të tjerë të lartë të përcaktuar nga autoriteti shqiptar pritës. Miqtë e huaj priten nga homologu shqiptar në vendin e caktuar për takim.

1.27 Pala pritëse përballon shpenzimet e qëndrimit në përputhje me parimin e reciprocitetit.

1.28 Ruajtjen dhe sigurimin e personalitetit të huaj gjatë gjithë kohës së vizitës dhe qëndrimit të tij në Shqipëri, si dhe ceremoninë e rojës së nderit e bën Garda e Republikës. Gardës i jepet programi i përgatitur i vizitës disa ditë përpara (jo më vonë se 48 orë përpara).

2. Përdorimi i sallës VIP të aeroportit

2.1 Përdorimi i sallës VIP drejtohet nga Protokolli i Shtetit. Salla VIP e Aeroportit "Nënë Tereza" është e formuar nga tri mjedise, shfrytëzimi i të cilave është i diferencuar dhe bëhet në bazë të rregullave të mëposhtme.

2.2 Salla A rezervohet për këto autoritete:

- kryetarë shteti (President Republike, Mbret, Princ trashëgimtar); kryetarë qeverie;
- kryetarë parlamenti;
- homologët e personaliteteve të mësipërm.

2.3 Salla B rezervohet për këto autoritete:

- kryetari i Gjykatës Kushtetuese; anëtarë të Këshillit të Ministrave; ish-President i Republikës; *ish-kryetar i Kuvendit;*
- ish-Kryeministër,
- kryetari i partisë më të madhe opozitare;
- deputetë;
- kryetari i Bashkisë së Tiranës;
- kryetari i Gjykatës së Lartë;
- kryetar i KLSH-së;
- prokurori i përgjithshëm;
- guvernatori i Bankës së Shqipërisë;
- shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë;
- Avokati i Popullit
- kryetari i SHISH-it;
- kryetarët e klerit;
- Sekretar i Përgjithshëm i Presidencës, Kuvendit, Këshillit të Ministrave;
- grada gjeneral për kryetar delegacioni në vizitë zyrtare;
- homologët e tyre të huaj.

2.4 Kërkesa për shfrytëzimin e sallës VIP bëhet në formën e një shkrese/note verbale dhe i drejtohet Protokollit të Shtetit për miratim, minimalisht 48 orë para udhëtimit. Përjashtimet nga rregulli i mësipërm gjykohen rast pas rasti.

2.5 Në sallën VIP të Aeroportit ka edhe një sallë konferencash shtypi, ku Presidenti, kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme e personalitetet e tyre homologe mund t'u drejtohen gazetarëve. Ky mjedis është i vetmi i dedikuar për konferenca dhe intervista apo takime të veçanta me mediat. Si rregull, vetëm në këtë mjedis kameramanët dhe fotografët mund të marrin plane. Përjashtime mund të autorizohen vetëm me miratim të Drejtorisë së Protokollit të Shtetit.

3. Bisedimet

3.1 Bisedimet zyrtare ndërmjet dy delegacioneve zhvillohen në tavolinë. Delegacionet zënë vend përballë njëri-tjetrit sipas rangut dhe vendeve të caktuara në tavolinë. Në tavolinë vendosen flamuj të vegjël kombëtarë. Mund të vendosen edhe flamuj të mëdhenj kombëtarë.

3.2 Nëse takimi është i karakterit formal ose kortezie, si rregull kryhet ulur në një sallon pritjeje. Në këtë formë zhvillohen kryesisht takimet kur rangu i bashkëbiseduesve nuk është i barabartë.

3.3 Takimet homologe dypalëshe zhvillohen në tavolina drejtkëndëshe ato trepalëshe në tavolinë në formë U-je, me delegacionin pritës në qendër dhe, nëse janë katër delegacione, përdoret një tavolinë katrore.

3.4 Nëse delegacionet janë pesë ose më shumë, përdoret tavolinë vezake ose drejtkëndëshe, ku delegacioni pritës qëndron në pjesën e ngushtë të saj. Në rastet kur është e nevojshme që të evidentohet barazia formale e pjesëmarrësve dhe të evitohet pozicioni hierarkik i presidencës së takimit, atëherë përdoret tavolinë katrore ose e rrumbullakët.

3.5 Në të gjitha llojet e bisedimeve lejohet pjesëmarrja fillestare e medias dhe bëhen fotografi zyrtare të delegacioneve ose të kryetarëve të tyre. Në takime marrin pjesë sekretarët stenografë.

3.6 Personaliteteve të shquara që marrin pjesë në takim u kërkohet kortezia e nënshkrimit në librin e nderit të vizitës.

4. Nënshkrimi i marrëveshjeve

4.1 Nënshkrimi i marrëveshjeve dy- ose shumëpalëshe është një moment solemn, i cili kërkon një protokoll të veçantë dhe të kujdesshëm. Ceremonia duhet të respektojë këto rregulla bazë:

- tavolina e firmosjes duhet të ketë madhësi të përshtatshme me numrin e firmëtarëve, të cilët ulen të gjithë nga e njëjta anë e saj;
- autoriteti pritës e vendos mikun në krah të djathtë. Nëse janë më shumë se dy, vendasi qëndron në mes;
- në tavolinë sistemohen që më parë dosjet e marrëveshjes dhe penat;
- pas nënshkruesve vendosen flamujt kombëtarë dhe përfaqësues, të cilët duhet të jenë të të njëjtës madhësi. Mundet që përveç flamujve të mëdhenj të vendosen edhe flamuj të vegjël tavoline;
- të paktën dy vetë ndihmojnë firmëtarët gjatë procedurës së firmosjes;
- media sistemohet përballë tavolinës së firmosjes, jo më afër se 2–3m distancë.
- delegacionet përkatëse zënë vend në krah të kryetarit të tyre ose pas tij;
- nëse marrëveshja nuk nënshkruhet nga autoritetet më të larta të pranishëm në ceremoni, këta të fundit zënë vend pas nënshkruesve ose ulur në tavolinë në mes të tyre.

5. Shkëmbimi i dhuratave

5.1 Në rastet e vizitave, takimeve dhe në përgjithësi gjatë ushtrimit të detyrës shtetërore, personaliteteve të larta të shtetit u jepen dhurata nga njerëz dhe institucione. Presidenti, kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, shkëmbejnë dhurata në shenjë kortezie me personalitetet e huaja homologe.

5.2 Vlera e dhuratës nuk duhet të kapërcejë kufijtë e mirësjelljes, rregullat apo limitet ligjore që shtete të ndryshme mund të kenë vendosur, si dhe reciprocitetin. Për çdo dhuratë të dhënë hartohet dokumentacioni përkatës përshkrues. Institucionet rekomandohen të bëjnë personalizimin e dhuratave.

5.3 Autoritetet kryesore nuk i shkëmbejnë vetë dhuratat në takimet zyrtare, përveç rasteve të veçanta kur bihet dakord që më parë për këtë. Në çdo rast tjetër, dhuratat shkëmbehen nëpërmjet protokolleve përkatëse.

5.4 Protokolli i Shtetit ka të drejtë të japë dhurata në mungesë të autoriteteve të larta shqiptare dhe në emër të tyre.

5.5 Të gjitha rangjet zyrtare, që kanë të drejtë të shkëmbejnë dhurata me homologë të huaj, mund të japin ose të pranojnë të tilla deri në shumën 75 000 lekë për çdo rast. Kjo shumë mund të

kapërcehet vetëm në rastet kur personi, të cilit do t'i jepet dhurata zë vend të veçantë për Shqipërinë. Çdo dhuratë regjistrohet në natyrën e saj, datën, vendin dhe arsyen për të cilën është dhënë.

5.6 Në rastet kur dhurata kalon shumën e përcaktuar me ligj, për të mos fyer dhuruesin mik dhe krijuar keqkuptime në marrëdhëniet midis vendeve, dhurata pranohet, por kthehet në pronë të shtetit shqiptar dhe bëhet pjesë e inventarit të institucionit që e ka pranuar. Ajo ekspozohet në vendin e duhur me sqarimin përkatës të dhuruesit.

5.7 Për autoritetet kryesore të shtetit, Presidentin e Republikës, kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, blerja e dhuratave që shkëmbehen me homologët e tyre dhe personalitete të larta të huaja, bëhet me prokurim të drejtpërdrejtë.

6. Pritja e delegacioneve jo të nivelit të lartë

6.1 Kur delegacionet e huaja që vijnë në Republikën e Shqipërisë kryesohen nga personalitete të nivelit ministër dhe më ulët, priten dhe përcillen në aeroport nga përfaqësues të institucionit pritës në nivel jo më të ulët se drejtor drejtorie.

6.2 Këto delegacione priten pa ceremoni zyrtare dhe ngritje flamujsh. Flamujt e të dyja vendeve ngrihen në ministritë përkatëse vetëm kur delegacioni kryesohet nga ministri i Punëve të Jashtme.

6.3 Delegacionet e huaja të kryesuara në nivel ministri mund të priten në takime të veçanta nga Presidenti i Republikës dhe Kryeministri, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e marrëdhënieve me jashtë. Delegacionet legjislative të të njëjtit rang priten nga kryetari i Kuvendit.

6.4 Programi i vizitës dhe organizimi i saj hartohet dhe zbatohet nga strukturat e institucionit pritës.

6.5 Në të gjitha rastet e vizitave të nivelit ministër ose të barabartë me të, vihet në dijeni për programin e vizitës Ministria e Punëve të Brendshme jo më vonë se 48 orë përpara mbërritjes së personalitetit të huaj.

6.6 Ceremonia e pritjes së një ministri Mbrojtjeje ose shefi Shtabi të Përgjithshëm bëhet në Ministrinë e Mbrojtjes ose në një objekt ushtarak. Ceremonia zhvillohet në prani të truprojës ushtarake të nderit dhe drejtohet nga protokolli i Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Përcjellja e delegacioneve shqiptare të nivelit të lartë

7.1 Kur Presidenti i Republikës, kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri udhëtojnë jashtë vendit për vizitë shteti ose zyrtare, një punonjës nga protokolli i institucionit përkatës udhëton për në vendin pritës, jo më pak se 2 ditë më parë për t'u njohur me të gjitha detajet e përgatitjeve të vizitës. Kur gjykohet e përshtatshme këtë aktivitet e kryen përfaqësia diplomatike e Republikës së Shqipërisë e akredituar në vendin përkatës.

7.2 Në përcjelljen e Presidentit merr pjesë shefi i zyrës së protokollit të Presidentit, në përcjelljen e kryetarit të Kuvendit merr pjesë shefi i zyrës së protokollit të Kuvendit, në përcjelljen e Kryeministrit merr pjesë shefi i zyrës së protokollit të Kryeministrit. Përcjellja e ministrit të Punëve të Jashtme organizohet nga Protokolli i Shtetit. Në rastet e vizitave shtetërore ose zyrtare, kur kërkohet nga kabineti i Presidentit të Republikës ose kabineti i Kryeministrit, përcjellja e autoriteteve të larta bëhet edhe me pjesëmarrjen e drejtorit të Protokollit të Shtetit.

7.3 Në të njëjtën mënyrë organizohet edhe pritja në aeroport e Presidentit, kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme.

7.4 Autoritetet e mësipërme vijnë në aeroport vetëm disa çaste përpara nisjes së avionit. Anëtarët e tjerë të delegacionit kryejnë të gjitha formalitetet përpara mbërritjes së autoritetit dhe hipin të parët në avion. Personi i ngarkuar me protokollin e personalitetit kryen të gjitha formalitetet përpara mbërritjes së tij në aeroport.

7.5 Bagazhet e regjistruara të delegacionit udhëtues duhet të kenë të njëjtën shenjë dalluese për të lehtësuar procedurat në nisje dhe mbërritje. Për përgatitjen e tyre ngarkohet administrata e dikasterit, e cila ia dorëzon ato zyrës së protokollit përkatës.

8. Pritja e personaliteteve të rëndësishëm pa rang zyrtar

8.1 Nëse në Shqipëri vijnë për vizitë të ftuar nga autoritetet e larta të vendit, personalitete të veçanta pa rang zyrtar, por të rëndësishëm dhe të nivelit të lartë në vendin e tyre si, princ jo trashëgimtar, drejtues fondacionesh të rëndësishme, përfaqësues të mëdhenj të artit, kulturës, të familjeve të mëdha botërore ose të tjerë të barabartë me këtë nivel, ndaj tyre zbatohet një protokoll i veçantë.

8.2 Nëse ardhja e tyre është negociuar në rrugë diplomatike, priten nga zyrtarë të Protokollit të Shtetit, përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe trajtohen si vizitorë me status diplomatik. Nivelin e pritjes e përcakton Protokolli i Shtetit.

8.3 Nëse vizita bëhet me ftesë private nga një prej autoriteteve të larta shqiptare, personaliteti i huaj mund të pritet nga vetë autoriteti që e ka ftuar ose përfaqësues të tij dhe protokolli i brendshëm i institucionit pa ceremoni zyrtare.

KAPITULLI VI
RADHA E PËRPARËSISË DHE AKTIVITETET CEREMONIALI

(Shtuar nënpika 6.5 e pikës 6 me VKM nr. 822, datë 22.11.2017; ndryshuar nënndarje në nënpikën 6.2 të pikës 6 me VKM nr. 587, datë 9.10.2018)

1. PËRPARËSIA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

I

Presidenti i Republikës
Kryetari i Kuvendit
Kryeministri
Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

II

Nënkryetarët e Kuvendit
Anëtarët e Këshillit të Ministrave
Ish-President
Ish-Kryeministër
Ambasadorët e vendeve të huaja të akreditуar në shtetin shqiptar
Kryetari i partisë më të madhe opozitare
Kryetarët e grupeve parlamentare, sipas përfaqësimit në parlament
Kryetarët e komisioneve parlamentare
Deputetët
Kryetari i Bashkisë së Tiranës
Kryetari i Gjykatës së Lartë
Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit
Prokurori i Përgjithshëm i Republikës
Guvernatori i Bankës së Shqipërisë
Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë
Avokati i Popullit
Kryetari i SHISH-it
Krerët e komuniteteve fetare
Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese
Anëtarët e Gjykatës së Lartë
Trashëgimtarët e familjes mbretërore
Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës, Kuvendit, Këshillit të Ministrave
Zëvendësministrat

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme
Drejtorët e Kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Kuvendit
Drejtori i Protokollit të Shtetit
Këshilltarët e Kryeministrit dhe Këshilltarët e Presidentit të Republikës
Prefekti i Tiranës
Komandantët e Armëve të Ushtrisë me gradë gjeneral
Kryetarët e partive parlamentare jodeputetë
Avokati i Shtetit
Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit
Komandanti i Gardës së Republikës
Personalitete të dekoruar me urdhra dhe medalje kombëtare
Kryetari i Akademisë së Shkencave
Presidenti i Këshillit të Rektorëve të Republikës
Ambasadorë të karrierës
Kryetari i Qarkut të Tiranës
Kryetarët e organizatave të veteranëve të LANÇ-it

III

Prefektët
Kryetarët e bashkive
Kryetari i Gjykatës së Apelit të Tiranës
Kryetari i Gjykatës së Apelit Administrativ
Kryetari i Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda
Kryetarët e gjykatave të apelit në rrethe
Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Tiranë
Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit të Krimeve të Rënda
Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës
Kryetari i Gjykatës Administrative e Shkallës Parë Tiranë
Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda
Kryetarët e gjykatave të shkallës së parë në rrethe
Kryetarët e gjykatave të shkallës së parë administrative në rrethe
Rektorët e universiteteve
Prokurori i Rrethit Gjyqësor të Tiranës
Drejtuesit e prokurorive në rrethe

1.1 Ndër të kualifikuarit me të njëjtin rang, përparësinë e ka më i vjetri në detyrë dhe më tej më i vjetri në moshë.

1.2 Ndër të kualifikuarit me rang të barabartë prioritetin e ka një i huaj.

1.3 Krerët e Shteteve kanë të gjithë rang të barabartë, presidentë apo mbretër qofshin, prandaj përparësia vendoset mbi bazën se kush është më i vjetër në detyrë dhe më tej në moshë.

1.4 Ambasadorët shqiptarë në detyrë, në raste shoqërimi të autoriteteve të larta të vendit tonë në vendet ku janë akreditуar ose anasjelltas, radhiten menjëherë pas anëtarëve të qeverisë.

1.5 Bashkëshortet gëzojnë rangun e titullarit dhe zënë vend bashkë me ta në të njëjtën radhë kur ftesa është çift. Në rastin kur titullari mungon, automatikisht e humbasin privilegjin e rangut, me përjashtim të bashkëshortes së Presidentit, Kryeministrit dhe kryetarit të Kuvendit.

1.6 Në raste ceremonish të një natyre specifike, e cila lidhet me ngjarje dhe manifestime të një karakteri të përcaktuar, mund të ndodhë që të bëhen përjashtime në radhën e përparësisë së rangjeve. Në këto raste është natyra e ceremonisë që kushtëzon edhe radhën e vendosjes ndryshe të

personaliteteve. Kjo bëhet brenda limiteve të caktuara dhe sipas një programi të miratuar që më parë.

2. Përparësia e organeve të pushtetit vendor

2.1 Për përcaktimin e radhës së përparësisë së organeve të pushtetit vendor nuk merret për bazë kriteri i madhësisë së territorit dhe as ai i numrit të popullsisë, sepse në bazë të Kushtetutës të gjithë qytetarët janë të barabartë pavarësisht nga njësia vendore ku jetojnë.

2.2 Kriteri bazë është ai përfaqësues ose më saktë pesha politike dhe social-ekonomike e njësisë vendore. Brenda kategorisë radha përcaktohet sipas rendit alfabetik të bashkive.

2.3 Radha e përparësisë në njësinë vendore është:

- prefekti (bën përjashtim pushteti vendor i kryeqytetit);
- kryetari i bashkisë;
- deputeti;
- kryetari i Këshillit të Qarkut;
- kryetari i Gjykatës së Apelit (civil, administrativ, apo i krimeve të rënda) në rastet kur ceremonia zhvillohet në qytetin ku kanë selinë këto institucione);
- drejtuesi i Prokurorisë së Apelit (Apelit të Krimeve të Rënda, në rastet kur ceremonia zhvillohet në qytetin ku kanë selinë këto institucione);
- kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë (civile apo administrative);
- drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit;
- drejtori i policisë;
- komandanti i njësisë ushtarake;
- kryetarët e besimeve fetare;
- rektori i universitetit;
- anëtari i këshillit bashkiak;
- drejtuesit e zyrave të bashkisë;
- kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë;
- drejtuesi i zyrës së tatimeve;
- drejtuesi i policisë tatimore;
- drejtorët e shkollave të mesme.

3. Elemente të ceremonive zyrtare

3.1 Ecja zyrtare, organizohet duke respektuar radhën e parë të saj, e cila si rregull duhet të jetë me numër tek. Vendi i nderit është në mes sipas renditjes: 4-2-1-3-5. Kur numri i personave të caktuar në radhën e parë është çift, vendi i nderit është në të djathtë: 1-2-3-4.

3.2 Kur personalitetet nisen për të zënë vend në një tribunë, ata ecin në mënyrë të tillë: 2-1-3 dhe në fund të lëvizjes personalitetet zënë vendet e caktuara nga protokolli.

3.3 Vendi i nderit, konsiderohet ai në krah të djathtë nëse kemi dy vende ose i mesit, nëse janë tre. I dyti për nga rëndësia vjen vendi në të djathtë të vendit të mesit, i treti ai në të majtë dhe kështu me radhë. Nëse janë dy personalitete të të njëjtit rang, atëherë vendosen të dy në mes duke pasur në të dy krahët një numër të barabartë shoqëruesish.

3.4 Përcaktimi i vendeve në salla ndjek radhën e përparësisë së rangjeve të pjesëmarrësve. Pika e referimit është poltrona e mesit në radhën e parë ose poltrona e parë në të djathtë të rrugëkalimit në të cilën ulet personi më i rëndësishëm.

3.5 Për të respektuar ceremonialin duhet të përpilohet një hartë e qartë me mënyrën e ndarjes së vendeve sipas emrave të pjesëmarrësve në ceremoni dhe që iu shpërndahet pjesëmarrësve bashkë me ftesat.

3.6 Përshëndetja zyrtare në manifestime dhe festa të rëndësishme bëhet menjëherë pas fjalës së hapjes, të cilën e mban autoriteti më i lartë mikpritës.

3.7 Përshëndetjen e mban autoriteti më i lartë i shtetit, i ngarkuar sipas programit të evenimentit ose i caktuar që më parë me protokoll. Si rregull, nuk përshëndesin në të njëjtin aktivitet Presidenti i Republikës, kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri. Anëtarët e Këshillit të Ministrave nuk përshëndesin pas fjalës së Kryeministrit.

3.8 Nëse përshëndetja i delegohet për ta lexuar një përfaqësuesi zyrtar, ai e merr fjalën pas autoritetit më të lartë të pranishëm, i caktuar të përshëndesë i dyti. Bën përjashtim vetëm përfaqësuesi i Kryeministrit, i cili flet në vend dhe në emër të tij.

3.9 Përshëndetja kombëtare realizohet nga Presidenti i Republikës.

Lloj i veçantë ceremoniali i përshëndetjes kombëtare është edhe përshëndetja me breshërinë e 21 topave, e cila realizohet në këto raste:

- në orën 10:00 të çdo jubileu të datës 28 Nëntor në Vlorë;
- në marrjen e detyrës nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë;
- në funerale zyrtare.

3.10 Trupi diplomatik, duke qenë i akredituar pranë kryetarit të shtetit, ftohet të marrë pjesë në grup në ceremonitë më të rëndësishme zyrtare që jep ose merr pjesë Presidenti i Republikës dhe Kryeministri.

3.11 Në ceremonitë zyrtare vendi i shefave të përfaqësive është në tribunë pranë personaliteteve kryesore, në vendin e paracaktuar nga protokolli.

3.12 Vendosja në tribunën e nderit ndjek radhën si vijon: në qendër vendoset Presidenti i Republikës dhe në të dy krahët kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe mikpritësi ose organizatori i ceremonisë duke vijuar me ministrat. Titullarët e trupit diplomatik vendosen sipas përparësisë së tyre në të djathtë të tribunës qendrore, radha e parë, vendi i parë, duke filluar nga e djathta. Në të majtë të tribunës qendrore vendosen autoritete të tjera të vendit dhe të ftuar të tjerë.

3.13 Vendosja e autoriteteve në tribunë bëhet sipas përparësisë zyrtare, përveç përjashtimeve sipas rastit.

3.14 Kur në një ceremoni nuk ndodhet asnjë anëtar i Këshillit të Ministrave, prefekti është përfaqësuesi i qeverisë.

4. Ceremoni inaugurimi

4.1 Nëse autoritetet më të larta të shtetit marrin pjesë në inaugurime të objekteve, veprave dhe prodhimeve të reja, kjo përbën një ceremoni solemne, e cila organizohet me kujdesin e duhur.

4.2 Momentet kryesore të një inaugurimi janë si më poshtë:

- vendi ku bëhet inaugurimi duhet të jetë i zbrazur, për të treguar se do të jenë autoritetet që do të shkelin të parët. Njerëzit e ftuar duhet të kenë distancë nga vendi i nderit;
- autoritetet priten në mënyrë festive nga organizatorët dhe pjesëmarrësit e tjerë të ftuar me atë rast. Mund të ofrohen edhe lule;
- vepra që inaugurohet duhet të jetë e zbukuruar me flamuj, pankarta, lule etj. Është me vend që banda muzikore të ekzekutojë muzikë të përshtatshme për momentin. Mund të thirret edhe kleri për të bekuar veprën sipas ritit të fesë përkatëse;
- vendoset shiriti i kuq, që do të pritet nga autoriteti i nderit ose përgatiten materialet përkatëse, kur vendoset guri i parë. Guri i parë duhet të jetë i veçantë, mundësisht të ketë datën dhe emrin përkatës ose mund të vendoset gjithashtu një pllakë përkujtimore;
- nëse objekti është vepër arti, atëherë, duhet të jetë e mbuluar dhe e pajisur me shiritin e zbulimit.
- për të dhënë më saktë idenë e punës, është mirë që autoritetit të ftuar dhe atyre që e shoqërojnë t'u shpërndahen kaskat, dorëzat e punës dhe çdo material tjetër që përdoret nga punëtorët e vendit.

4.3 Inaugurimet mbyllen zakonisht me një koktej të ofruar nga organizatorët, të cilët falënderojnë të ftuarit për pjesëmarrjen në këtë ngjarje. Të ftuarit përcillen në të njëjtën mënyrë si priten.

5. Dekoratat dhe vënia e tyre

Dhënia e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve dhe titujve vendorë të nderit udhëhiqet nga parimet e vlerësimit të kontributit, meritokracisë, transparencës dhe mirënjohjes publike dhe bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit për dekoratat titujt e nderit medaljet dhe titujt vendorë në Republikën e Shqipërisë.

5.1 Dekorimi përbën një vlerësim zyrtar dhe në të njëjtën kohë publik të veprimtarisë së individëve në shërbim të shtetit dhe të shoqërisë. Interesi zyrtar është të bëjë të njohur veprimtarinë e merituar të personave të veçantë dhe të nxisë çdo individ drejt përmirësimit dhe progresit.

5.2 Shpërndarja e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve, bëhet sipas një ceremonie të veçantë në përputhje me parashikimet e ligjit për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë.

5.3 Dekoratat janë pjesë e veshjes zyrtare. Ato vendosen në të gjitha aktivitetet zyrtare, festa, pritje, raste solemne. Veshja e rekomandueshme për dekoratat është ajo e errët solemne, frak dhe uniforma ushtarake ceremoniale.

5.4 Në ceremonitë shtetërore dhe zyrtare distinktivët e llojeve të ndryshme si anëtarësi në klube, pjesëmarrje në manifestime, shoqata, ente publike e private, mund të mbahen dhe janë në përgjithësi të adaptueshëm për çdo lloj veshjeje por rekomandohet që të mbahen në veshje të përshtatshme me llojin e dekoratës.

6. Festat zyrtare, ditë përkujtimore dhe ditë të tjera, të shënuara

6.1 Në Republikën e Shqipërisë festohen dhe përkujtohen festat zyrtare, ditët përkujtimore publike dhe ditë të tjera, të shënuara në përputhje me këtë ceremonial.

6.2 Festat zyrtare janë ditë feste të përcaktuara me ligj. Festa zyrtare janë:

1 e 2 janar	Viti i Ri
14 Mars	Dita e Verës
22 Mars	Dita e Nevruzit
1 Maj	Dita e Punëtorëve
5 shtator	*Dita e Shenjtërimit të Shenjt Terezës*
28 Nëntor	Dita e Pavarësisë
29 Nëntor	Dita e Çlirimit të Atdheut
	Bajrami i Madh
	Bajrami i Vogël
	Pashkët Ortodokse
	Pashkët Katolike
25 Dhjetor	Krishtlindjet

Përveç kur pjesëmarrja e personaliteteve të larta shtetërore, sipas ceremonialit, të përcaktuar në këtë vendim, është e detyrueshme, pjesëmarrja në festat e tjera zyrtare, ditët e përkujtimit dhe ditët e shënuara bëhet në përputhje me traditën, nevojat apo kalendarin e personaliteteve.

Festat zyrtare, sipas ligjit, janë ditë pushimi.

6.3 Ditë përkujtimi publike janë ditë të rëndësishme përkujtimore. Ditë përkujtimi publike janë:

5 Maji	Dita e Dëshmorëve
21 Maji	Dita e Kujtesës Historike për Viktimat e Krimeve të Komunizmit
4 Dhjetori	Dita e Forcave të Armatosura
8 Dhjetori	Dita e Rinisë

Në ditët e festave zyrtare dhe ditët e përkujtimit publik, në selinë e institucioneve, shtetërore dhe private, vendosen flamuri kombëtar dhe shenjat dalluese të institucioneve apo enteve përkatëse.

6.4 Ditët e shënuara janë festa të karakterit fetar, vendor, ndërkombëtar, shoqëror apo politik, të cilat, për shkak të traditës ose të vlerave të veçanta, përkujtohen në Republikën e Shqipërisë. Ditë të shënuara janë:

6 Janar	Epifania-Uji i Bekuar
	Dita e Ashures
7 Mars	Dita e Mësuesit
8 Mars	Dita e Gruas
9 Maj	Dita e Evropës
20 Maj	Dita e Jetimëve
1 Qershor	Dita e Fëmijëve
16 Shtator	Festa e Pezës
1 Tetor	Dita e të Moshuarve
24 Tetor	Dita e OKB-së
17 Nëntor	Dita e Çlirimit të Tiranës
20 Nëntor	Dita e Alfabetit

Ministritë përgjegjëse, për ditët e shënuara, kombëtare apo ndërkombëtare, me karakter ndërgjegjësues, të caktuara sipas legjislacionit në fuqi, organizojnë veprimtari përkatëse, sipas rregullave të protokollit të tyre.

Në ditët e shënuara mund të përfshihen edhe ditë të tjera, përkujtimi ose festimi i të cilave, në nivel kombëtar, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në nivel vendor me vendim të njësive të organeve të qeverisjes vendore (p.sh. dita e ngritjes së flamurit në qytet apo e themelimit të qytetit). Veprimtaritë, që kryhen në përkujtim apo festim të ditëve të shënuara, përcaktohen, rast pas rasti, në vendimin e përkujtimit, ku, përveç ceremonisë, përcaktohen edhe masat për zbukurimin e shesheve qendrore. Pjesëmarrja e personaliteteve të larta shtetërore në përkujtimin e ditëve të shënuara bashkërendohet nga Protokolli i Shtetit.

6.5. Realizimi i dekorit të godinave të ministrive me rastin e festave zyrtare, të parashikuara në nënpikën 6.2., të këtij kapitulli, të bëhet nga Bashkia Tiranë, bazuar në kërkesat e ministrive. Marrëdhëniet ndërmjet ministrive dhe Bashkisë Tiranë për realizimin e dekorit të ministrive rregullohen me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

7. Ceremonia e ngritjes së flamurit kombëtar

7.1 Ngritja e flamurit në Vlorë më 28 Nëntor është ceremonia më solemne në Republikën e Shqipërisë. Ajo organizohet në qytetin e Vlorës çdo vit. Programi përpunohet nga Protokolli i Shtetit.

7.2 Në ceremonitë e organizuara çdo vit marrin pjesë të ftuar:

- personalitetet kryesore shtetërore dhe publike shqiptare;
- trashëgimtarë të familjes së Ismail Qemal Vlorës.

7.3 Në ceremonitë e organizuara në përvjetor jubilar ngrihet një komision qeveritar i kryesuar nga zëvendëskryeministri. Programi përfundimtar përpunohet nga Protokolli i Shtetit. Në ceremoni marrin pjesë të ftuar:

- personalitetet kryesore shtetërore dhe publike shqiptare;
- trupi diplomatik rezident dhe jorezident i akreditуar në Shqipëri;
- trashëgimtarë të familjes së Ismail Qemal Vlorës;
- personalitetet më në zë të diasporës dhe të trojeve shqiptare jashtë kufijve;
- personalitete të huaja që kanë dhënë dhe japin kontribut të shquar në interes të Shqipërisë.

7.4 Ceremonia fillon në orën 10:00. Të ftuarit arrijnë më parë sipas itinerarit të përcaktuar. Në përvjetor jubilar, organizimi i pjesëmarrjes së trupit diplomatik bëhet nga Protokolli i Shtetit.

7.5 Pranë Monumentit të Pavarësisë, në pjesën e pasme ngrihet një tendë e përkohshme, ku mblidhen personalitetet para se të fillojë ceremonia.

7.6 Me ardhjen e Presidentit të Republikës fillon ceremonia. Vargu i personaliteteve drejtohet nga Protokolli për te vendi i ngritjes së flamurit. Ecja ceremoniale bëhet sipas skemës 4-2-1-3-5. Presidenti shoqërohet nga kryetari i bashkisë, kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Prefekti i Vlorës dhe anëtarë të familjes Vlora.

7.7 Presidenti i Republikës ecën jo më shumë se dy hapa para të tjerëve. Komandanti i truprojës ushtarake të nderit i afrohet dhe i paraqet forcën. Në orën 10:00, Presidenti kryen ngritjen ceremoniale të flamurit.

7.8 Ngritja e flamurit shoqërohet nga himni kombëtar dhe përshëndetet nga 21 të shtëna artilerie. Të gjithë të pranishmit mbajnë drejtqëndrim.

7.9 Pas ngritjes së flamurit, nga të pranishmit vendosen kurora në emër të kombit shqiptar te varri i Ismail Qemalit. Ecja e personaliteteve bëhet sipas skemës përkatëse dhe shoqërohet me marshe solemne. Familja Vlora, asociohet, sipas skemës së përgatitur nga Protokolli i Shtetit, në radhitjen mes personaliteteve dhe vendosjen e kurorave.

7.10 Në përvjetor jubilar, Presidenti i Republikës, kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri zënë vend në tribunën e ngritur në këmbët e Monumentit të Pavarësisë. Të ftuarit e tjerë, anëtarët e qeverisë, trupi diplomatik, deputetë, përfaqësues të partive politike, familje patriotësh, përfaqësues të diasporës etj., janë të vendosur që më parë sipas përparësisë në tribunë.

7.11 Në përvjetor jubilar, Presidenti i Republikës u drejtohet pjesëmarrësve dhe mbarë kombit me përshëndetjen e rastit. Ceremonia mbyllet pas përshëndetjes së Presidentit.

7.12 Nëse parashikohen në program aktivitete të tjera, përurimi i tyre bëhet sipas radhës së përparësisë nga personalitete të tjera. Në këto ceremoni marrin pjesë të gjitha personalitetet kryesore të shtetit.

7.13 Vizitat në familjet e patriotëve dhe dëshmorëve janë fakultative dhe bëhen sipas programit të miratuar më parë për secilin personalitet më vete dhe jo më shumë se dy vizita. Presidenti i Republikës shoqërohet nga kryetari i bashkisë, Kryeministri nga Prefekti dhe kryetari i Kuvendit nga kryetari i Qarkut.

7.14 Si rregull, në përvjetor jubilar, për nder të të gjithë pjesëmarrësve, pushteti vendor i Vlorës shtron një drekë. Kryetari i bashkisë ngre me këtë rast një dolli dhe përshëndet të gjithë të ftuarit. Ceremonia mbyllet në orën 16:00. Pjesëmarrësit shpërndahen për t'u mbledhur përsëri në Tiranë, për pritjen e festave zyrtare të Pavarësisë dhe të Çlirimit të Atdheut.

8. Ceremoniali për festat e Pavarësisë dhe Çlirimit të Atdheut

8.1 Në përkujtim të festave zyrtare të Pavarësisë dhe të Çlirimit të Atdheut, Protokolli i Shtetit organizon më 28–29 Nëntor të çdo viti, përkatësisht, këto aktivitete përkujtimore:

- ceremonia e ngritjes së flamurit kombëtar;
- pritje shtetërore;
- ceremoni në nderim të dëshmorëve të kombit.

Ceremonia e ngritjes së flamurit zhvillohet sipas pikës 2, të këtij kapitulli.

Ceremonia e nderimit të dëshmoreve të kombit: në nderim të dëshmorëve të kombit, Presidenti i Republikës, kryetari i Kuvendit, Kryeministri, ministri i Mbrojtjes, Prefekti, kryetari i bashkisë, kryetari i Këshillit të Qarkut, si dhe organizatat e veteranëve vendosin kurora në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë, ora 10:00.

Ceremoniali zhvillohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në pikën 5, të këtij kapitulli për nderimin e dëshmorëve të kombit. Çdo 29 Nëntor vendos një kurorë edhe trupi diplomatik i akreditуar në Republikën e Shqipërisë. Gjatë ceremonisë së vendosjes së kurorës nga dekani i trupit diplomatik, marshe funebre shoqërojnë ecjen dhe himni kombëtar ekzekutohet në fund të ceremonisë. Në ceremoni nuk ka truprojë nderi.

8.2 pritja shtetërore: pritja shtetërore me rastin e festave zyrtare të Pavarësisë dhe të Çlirimit të Atdheut organizohet në Pallatin e Brigadave, selinë e institucionit të Presidentit të Republikës, ose në rezidenca të tjera qeveritare, çdo 28 Nëntor, ora 19:30.

8.3 Të ftuar të Presidentit të Republikës janë, si më poshtë:

- trupi diplomatik rezident dhe jorezident i akreditуar në Republikën e Shqipërisë;
- personalitetet kryesore të shtetit, politikës, kulturës, artit dhe letërsisë në Shqipëri, sipas përparësisë;
- personalitetet më në zë të diasporës dhe trojeve shqiptare jashtë kufijve;
- personalitete të huaja që kanë dhënë dhe japin kontribut të shquar në interes të Shqipërisë;
- konsujt e nderit të Shqipërisë në vendet e huaja dhe ata që përfaqësojnë vendet e huaja në Shqipëri,
- pjesëmarrja e të ftuarve është bashkë me bashkëshortet përveçse kur parashikohet ndryshe. Ftesa është nominale dhe e pa transferueshme.

8.4 Të ftuarit vijnë në ambientet e Pallatit të Brigadave (rezidencës qeveritare) mes orës 19:00 dhe 19:25. Në orën 19:30 hapen dyert e sallës kryesore dhe të pranishmit fillojnë të futen në sallë. Ata priten në radhë nga Presidenti i Republikës, kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri me bashkëshortet (ose vetëm).

8.5 Mikpritja e autoriteteve të larta zgjat 30 minuta, pastaj ata prishin radhën dhe bashkohen me të ftuarit. Pas këtij momenti askush nuk mund të hyjë më në sallë.

8.6 Në orën 20:00, Presidenti i Republikës, kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri me bashkëshortet e tyre, shkojnë në krye të sallonit ku është vendosur mikrofoni.

8.7 Ekzekutohet himni kombëtar vetëm me muzikë. Përshëndet Presidenti i Republikës. Përshëndetja e tij shoqërohet nga përkthimi në anglisht për trupin diplomatik. Pas përshëndetjes Presidenti ngre një dolli urimi për të gjithë të ftuarit.

8.8 Të tria autoritetet e larta përshëndesin të ftuarit duke lëvizur në të gjitha mjediset e sallës së pritjes. Gjatë ceremonisë një grup muzikor ekzekuton pjesë të ndryshme muzikore.

8.9 Presidenti largohet i pari nga festa, pasi përshëndetet me personalitetet kryesore të huaja dhe të vendit. Pas tij mund të fillojnë të largohen edhe të ftuarit e tjerët sipas dëshirës.

8.10 Veshja e të ftuarve në këtë pritje rekomandohet të jetë kostum i errët, smoking, frak ose kostum kombëtar. Dekoratat mbahen në modelin e tyre të ordinancës.

8.11 Me rastin e festës së Çlirimit të Atdheut, çdo 29 nëntor, Kryeministri mund të organizojë një pritje zyrtare të ngjashme me atë që organizon Presidenti një ditë më parë.

9. Ceremonia e pritjes së Vitit të Ri Diplomatik

9.1 Gjatë muajit janar të çdo viti, Presidenti i Republikës, i shoqëruar nga ministri i Punëve të Jashtme, jep për trupin diplomatik një pritje me rastin e Vitit të Ri. Koordinimi i pjesëmarrjes së trupit diplomatik bëhet nga Protokolli i Shtetit.

9.2 Të ftuarit futen në sallën kryesore duke filluar nga ora 18:30. Në orën 19:00 lajmërohet me zë dhe futet në sallë, nga kreu i saj, Presidenti i Republikës me bashkëshorten i shoqëruar nga ministri i Punëve të Jashtme me bashkëshorten dekani i trupit diplomatik afrohet dhe përshëndetet i pari me Presidentin e Republikës dhe ministrin e Punëve të Jashtme.

9.3 Personalitetet e sipërshënuara zënë vend pranë mikrofonit në krye të sallës. Presidenti dhe bashkëshortja në qendër, ministri i Punëve të Jashtme dhe bashkëshortja vendosen në të majtë, kurse dekani në të djathtë.

9.4 Ekzekutohet himni kombëtar. Përshëndet të pranishmit Presidenti i Republikës dhe në emër të trupit diplomatik e merr fjalën dekani. Presidenti i Republikës ngre dolli dhe uron të pranishmit.

9.5 Presidenti i Republikës largohet i pari. Të tjerët fillojnë të largohen pas tij.

9.6 Pritja shoqërohet me muzikë. Veshja e të ftuarve rekomandohet të jetë kostum i errët, smoking, frak ose kostum popullor.

10. Ceremonia e vendosjes së kurorave te "Nëna Shqipëri"

10.1 Në nderim të dëshmorëve të kombit, më 5 maj të çdo viti, Presidenti i Republikës, kryetari i Kuvendit, Kryeministri, ministri i Mbrojtjes, Prefekti, kryetari i bashkisë, kryetari i Këshillit të Qarkut, si dhe organizatat e veteranëve, vendosin kurora në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, në Tiranë.

10.2 Kjo ceremoni ka vlera simbolike dhe gjatë vendosjes së kurorave mbahet qetësi e thellë nga pjesëmarrësit.

10.3 Kurora e rangut më të lartë vendoset e para. Kurora e Presidentit të Republikës vendoset në titull personal, të tjerat vihen në emër të institucioneve përkatëse. Kurorat mbahen nga truprojë nderi dhe ajo nuk mund të delegohet.

10.4 Ceremonia në përmendoren "Nëna Shqipëri" fillon në orën 10:00. Vendosen këto kurora sipas radhës:

- Presidenti i Republikës;
- kryetari i Kuvendit;
- Kryeministri;
- ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura;
- prefekti;
- kryetari i Bashkisë;
- kryetari i Këshillit të Qarkut;
- organizatat e veteranëve dhe dëshmorëve të atdheut.

10.5 Marshet funebre shoqërojnë ecjen ceremoniale. Himni kombëtar ekzekutohet kur të gjithë kanë mbaruar vendosjen e kurorave. Truproja e nderit është e pranishme gjatë ceremonisë në të majtë të tapetit të kuq.

10.6 Bashkia e Tiranës është përgjegjëse për përgatitjen e dekorit te Varrezat e Dëshmorëve të Kombit dhe rrugët që të çojnë atje. Në të gjitha qytetet e Shqipërisë bëhet e njëjta ceremoni nga autoritetet më të larta vendore.

11. Parada jubilare e Forcave të Armatosura

11.1 Ceremonia jubilare e paradës së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë zhvillohet një herë në pesë vjet, më 4 dhjetor. Parada dhe ceremonia organizohen nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes.

11.2 Tribuna e nderit ngrihet në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" ose në oborrin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe ndahet në tre sektorë kryesorë:

Në tribunën A zënë vend personalitetet si vijon:

- Presidenti i Republikës;
- Kryeministri;
- ministri i Mbrojtjes;
- Kryetari i Kuvendit;
- shefi i Shtabit të Përgjithshëm;
- zëvendëskryeministri;
- ministri i Punëve të Jashtme;
- ministri i Brendshëm;
- komandanti i Forcave Tokësore;
- komandanti i Forcave Ajrore;
- komandanti i Forcave Detare;
- komandanti i Komandës së Doktrinave dhe Stërvitjes Ushtarake;
- komandanti i Komandës së Mbështetjes Logjistike;
- anëtarët e tjerë të kabinetit;
- kryetari i Bashkisë së Tiranës.

Në përputhje me përparësinë e rangjeve në Republikën e Shqipërisë vijon vendosja në tribunën A dhe tribunën C sipas listës së miratuar të të ftuarve.

Në tribunën B vendosen shefat e misioneve diplomatike, atashetë ushtarakë, përfaqësues të misioneve ushtarake të vendosura në vendin tonë.

12. Zia kombëtare

12.1 Zia është një ceremoni solemne e respektit shtetëror e qytetar që zhvillohet në frymën e vlerave më të larta humane dhe parimeve universale të të drejtave të njeriut, demokracisë dhe lirisë të përcaktuara nga Kushtetuta.

12.2 Zia kombëtare shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe i komunikohet trupit diplomatik nëpërmjet Protokollit të Shtetit. Sipas rastit përcaktohet ngritja një komisioni të veçantë për organizimin e ceremonisë funebre.

12.3 Kohëzgjatja e zisë përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

12.4 Zia kombëtare është e detyrueshme për të gjitha institucionet shtetërore qendrore dhe vendore. Komisioni i krijuar në këtë rast përcakton të gjitha modalitetet e ceremonisë zyrtare funebre, komunikatën për shtyp.

12.5 Format e manifestimit të zisë kombëtare janë të përshkallëzuara. Flamuri kombëtar vendoset në gjysmështizë në të gjitha objektet publike.

12.6 Manifestohen edhe forma të tjera:

- një minutë heshtje në salla dhe auditorë publikë, si parlament, zyra, universitete, bashki, vende pune, shkolla, kazerma;
- mbyllje e pjesshme ose totale e lokaleve të shfaqjeve të ndryshme artistike me muzikë të lehtë;
- një minutë ndalim i të gjitha aktiviteteve publike në orën 12:00 ose gjatë zhvillimit të ceremonisë funebre;
- ekzekutim për një kohë të caktuar në radio dhe televizion vetëm i muzikës funebre;
- vendosje e një fashoje të zezë në krahun e majtë.

12.7 Ceremonitë funebre shtetërore dhe zyrtare përballohen nga Këshilli i Ministrave. Të tjerat përballohen nga administrata e institucionit përkatës.

12.8 Në homazhe zyrtare, funerale ose gjatë ceremonisë së varrimit marrin pjesë personalitete shtetërore ose personalitete zyrtare të huaja të ardhura me këtë rast. Mund të marrë pjesë edhe trupi diplomatik i akredituar në Republikën e Shqipërisë. Për homazhe hapet një libër ngushëllimi.

12.9 Zia qytetare shpallet nga administrata vendore. Vdekja e një prefekti, kryetari bashkie apo drejtuesi tjetër vendor të administratës shtetërore përkujtohet me një ceremoni funebër nga autoritetet vendore.

12.10 Zia qytetare ka një shtrirje të kufizuar në kohë dhe territor. Organizimi i saj bëhet nga pushteti vendor.

12.11 Gjatë zisë qytetare ulet në gjysmështizë vetëm flamuri i institucionit që ka shpallur zinë (jo flamuri kombëtar) dhe flamuri i institucioneve të tjera që e përkrahin dhe bashkohen me të.

13. Ceremonitë funebre

13.1 Ceremonitë funebre në Republikën e Shqipërisë janë shtetërore, zyrtare, ushtarake dhe jo të plota zyrtare e ushtarake. Të gjithë tipat janë ceremoni të rëndësishme, të cilat programohen deri në imtësitë më të vogla për të ruajtur solemnitetin dhe manifestuar respektin e merituar. Ceremonitë ushtarake organizohen nga protokolli i Ministrisë së Mbrojtjes.

13.2 Rangjet të cilave u takon t'u bëhet funeral shteti janë:

- Presidenti i Republikës në detyrë;
- Presidenti i Republikës i emëruar;
- kryetari i Kuvendit në detyrë;
- Kryeministri në detyrë;
- Kryeministri i emëruar,

- çdo personalitet tjetër që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

13.3 Personalitetet të cilëve u kryhet funeral shtetëror varrosen në Varrezat e Kombit në aneksin e njerëzve të shquar të tij.

13.4 Në rastin e ceremonisë mortore që organizohet për një President në detyrë, kryetar Kuvendi ose Kryeministër, arkivoli vendoset në shtratin e topit i mbuluar me flamur kombëtar dhe shoqërohet nga truproja e nderit të Republikës.

13.5 Ulja e arkivolit në varr shoqërohet me të shtëna nga truproja e nderit. Të gjitha personalitetet zyrtare pjesëmarrëse në ceremoni duhet të vendosin një shirit të zi në krahun e majtë. Ushtarakët marrin drejtqëndrim. Nderimi me të shtëna u rezervohet:

- Presidentit të Republikës 21 të shtëna (topi)
- Kryetarit të Kuvendit 21 të shtëna (armë)
- Kryeministrit 19 të shtëna (armë)
- ministrave 15 të shtëna (armë)
- shefit të Shtabit të Përgjithshëm 15 të shtëna (armë)

13.6 Pjesëmarrja në këtë ceremoni kërkon detyrimisht veshje të errët (kostum dhe kravatë të errët, këmishë të bardhë dhe këpucë të zeza, pallto ose pardesy të errët). Për ushtarakët parashikohet uniforma ceremoniale.

13.7 Në të gjitha përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit hapet libri i ngushëllimeve. Nëse në ceremoni marrin pjesë kryetarë shteti të huaj, ata trajtohen sipas kësaj skeme: priten nga Protokolli i Shtetit, pa bandë, me truprojë të reduktuar, tapet të kuq dhe shoqërohen gjatë gjithë kohës së qëndrimit deri në largim.

14. Ceremoni funebre shtetërore

14.1 Kur Këshilli i Ministrave vendos për kryerjen e një ceremonie funebre shtetërore dhe familja e të ndjerit e pranon këtë lloj funerali, ngrihet një komision ku bën pjesë edhe Protokolli i Shtetit.

14.2 Protokolli i Shtetit koordinon punën me Gardën e Republikës, Bashkinë e Tiranës, Drejtorinë e Policisë së Qarkut, Zyrën e Shtypit të Kryeministrit, për zhvillimin e ceremonisë funebre.

14.3 Trupi i të ndjerit vendoset në hollin e Pallatit të Kongreseve ose në ndonjë rezidencë tjetër qeveritare në bulevardin "Dëshmorët e Kombit", ku fillojnë edhe homazhet zyrtare dhe publike për përcjelljen e tij për aq ditë sa është zia e shpallur. Rrugëkalimi i njerëzve rregullohet nga truproja e nderit me uniformë ceremoniale. Për kryerjen e homazheve publike vendoset një orar i caktuar gjatë gjithë periudhës së zisë.

14.4 Pranë trupit krijohet një vend i posaçëm për familjen dhe të afërmit e të ndjerit. Në hyrje vendoset tavolina me librin e ngushëllimeve. Mbi të vendoset portreti i të ndjerit dhe në të djathtë flamuri kombëtar. Në të dy krahët mbajnë drejtqëndrim dy truproja nderi.

14.5 Lëvizja e kortezhit bëhet në orën 10:00. Arkivoli i vendosur në shtrat topi, i mbuluar me flamur kombëtar niset nga vendndodhja, i shoqëruar nga gjashtë truproja nderi, tri në çdo anë. Përpara kortezhit ecën truproja e nderit e Gardës së Republikës dhe truprojat me jastëkët e kuq të dekoratave. Pas tyre vendoset banda, që ekzekuton marshe funebër. Familjarët dhe personalitetet ecin pas shtratit të topit dhe më pas pjesëmarrës të tjerë.

14.6 Kortezhi ecën në këmbë deri tek Ura e Lanës dhe prej këtej drejtohet i motorizuar te Varrezat e Kombit. Pranë varrit janë përcaktuar vende të veçanta për familjarët, personalitetet e larta pjesëmarrëse dhe për truprojën e nderit.

14.7 Arkivoli vendoset në mbajtësen e posaçme. Truproja e nderit merr drejtqëndrim "për nder armë" gjatë lëvizjes së arkivolit. Personaliteti i caktuar bën përshëndetjen e rastit (3 min). Nga arkivoli hiqet flamuri me palosje dhe arkivoli vendoset pranë varrit.

14.8 Ulja në varr e arkivolit paraprihet nga të shtënat e nderit. Skuadra përbëhet nga 5-7 ushtarë dhe komandohet nga një oficer. Armët mbahen 45 gradë nga horizontalja, me drejtim mbi varr. Të

shtënat komandohen nga oficeri i truprojës. Mbas të shtënave skuadra merr drejtqëndrim "për nder armë".

14.9 Fillon ulja e arkivolit në varr. Gjatë varrimit mbahet heshtje.

14.10 Personalitetet e pranishme ngushëllojnë familjen e të ndjerit dhe largohen. Shpenzimet e funeralit shtetëror përballohen nga Këshilli i Ministrave.

14.11 Ceremonia përmbledh këto momente kryesore:

- rregullimi i hollit të Pallatit të Kongreseve për homazhet;
- lista e pjesëmarrësve, personalitete, të huaj, miq, familjarë;
- njoftimi i trupit diplomatik;
- ceremonia fetare, nëse është e nevojshme dhe mënyra e vendosjes së pjesëmarrësve;
- rregullimi i shtratit të topit dhe flamurit që do të mbulojë arkivolin;
- rrugëkalimi i kortezhit të përmortshëm;
- oficeri drejtues;
- truproja e nderit;
- Banda e Republikës;
- motoçikletat e shoqërimit;
- bërja gati e vendvarrimit në Varrezat e Kombit;
- mbajtësit e arkivolit.

15. Ceremoni funebre zyrtare

15.1 Ceremonitë funebre zyrtare organizohen për personalitete të cilët nuk janë të përfshirë në pikën 13.2. Shpallja e zisë përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

15.2 Ceremonia e homazheve organizohet (me lejen e familjes), në institucionin përkatës, ku vendoset arkivoli dhe hapet libri i ngushëllimeve. Në orën e caktuar, kortezhi i përmortshëm niset drejt varrezave i eskortuar vetëm nga patrulla policore.

15.3 Kjo ceremoni nuk përmban bandë, truprojë nderi dhe të shtëna me armë. Në varreza marrin pjesë personalitete të larta të shtetit. Pas mbajtjes së përshëndetjes së fundit, arkivoli zbret në varr. Pjesëmarrësit qëndrojnë në heshtje deri në fund dhe pasi përshëndeten me familjen, largohen.

15.4 Organizimi i ceremonisë dhe shpenzimet e funeralit përballohen nga institucioni përkatës.

16. Vdekja e një personaliteti të huaj

16.1 Nëse një personalitet i lartë i huaj ndërron jetë, homologët shqiptarë dërgojnë në misionin përkatës diplomatik të akredituar në Tiranë nga një përfaqësues të tyre për të shprehur ngushëllimet e rastit dhe për të bërë shënimin përkatës në librin e hapur me këtë rast. Ata shkruajnë mesazhin, për të cilin janë ngarkuar, në emrin e personalitetit që përfaqësojnë.

16.2 Nëse ndërron jetë një kryetar shteti, qeverie ose ministër i punëve të jashtme, ministri shqiptar i Punëve të Jashtme viziton personalisht ambasadorin përkatës. Homologu shqiptar bën ngushëllime personalisht dhe nënshkruan në librin e ngushëllimeve. Autoritetet e tjera mund të dërgojnë sipas dëshirës një përfaqësues.

16.3 Përfaqësuesit e lartë të shtetit mund të shkojnë në ceremoninë e varrimit të një personaliteti të lartë politik të një shteti tjetër. Niveli i përfaqësimit duhet t'i përmbahet rangut të personalitetit të huaj që ka ndërruar jetë.

16.4 Në rast vdekjeje të një kardinali, ngushëllimet i drejtohen Nuncit Apostolik. Kryeministri i dërgon mesazh Sekretarit të Shtetit të Vatikanit, kurse Presidenti i Republikës i drejtohet Papës.

17. Vendosja e autoriteteve në tribunën VIP të stadiumeve në rastet e ndeshjeve të skuadrës kombëtare

17.1 FSHF-ja (enti përkatës) mundëson në çdo rast të ndeshjeve të skuadrës kombëtare vendosjen në tribunën VIP të Presidentit të Republikës, kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, si edhe ministrave të kabinetit qeveritar. Vendosja ndjek radhën e përparësisë duke filluar nga qendra e tribunës dhe përshtatet sipas kushteve të tribunave VIP në stadiumet sportive në vend. Në çdo rast

FSHF-ja (enti përkatës) konsultohet për zbatimin e përparësisë me drejtorinë e Protokollit të Shtetit dhe merr në konsideratë sugjerimet e saj.

18. Ceremonitë funebre në Republikën e Shqipërisë

Tipi / Rangu	Shteti	Zyrtare	Ushtarake	Zyrtare ose ushtarake jo e plotë
President i Republikës	X			
Kryetar Kuvendi	X			
Kryeministër	X			
President i zgjedhur i Republikës	X			
Rast i veçantë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave	X			
Kryetar i Gj. Kushtuese		X		
Zv. Kryeministër		X		
Ministra		X		
Ish Presidentë, ish Kryetar Kuvendi, ish Kryeministra		X		
Nënkryetar kuvendi				
Deputetë e te barabartë në rang		X		
Shefi i Shtabit të Ushtrisë		X		
Emërtesa të Presidentit dhe Kryeministrit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave		X	X	X
Gjeneral Komandant divizioni			X	
Ish-drejtues në pension sipas vendimit të institucionit				X
Komandant arme dhe të barabartë			X	
Ish-oficerë madhorë në pension. Sipas rregullores së Ministrisë së Mbrojtjes			X	X
Gradat e ulëta. Sipas rregullores të M.M dhe M.R.P				X

KAPITULLI VII

PRIVILEGJE DHE IMUNITETE

(Ndryshuar emërtim në nënpikën 1.3 të pikës 1 me VKM nr. 587, datë 9.10.2018; ndryshuar titulli i pikës 5, pika 5.8, togfjalësha në pikat 5.19 dhe 5.24 me VKM nr. 125, datë 2.3.2022)

1. Pajisja me kartë identiteti

1.1 Ministria e Punëve të Jashtme njoftohet menjëherë me anë të një note verbale për mbërritjen e anëtarëve të rinj të përfaqësive diplomatike, organizatave ndërkombëtare të akredituara në Shqipëri. Në notë shënohet emri dhe funksioni i anëtarit dhe shpjegohet nëse është post i ri apo zëvendësim i një anëtari i cili ka mbaruar misionin në Shqipëri. Për atashetë ushtarakë, anëtarë të përfaqësive diplomatike, akreditimi duhet të merret në Ministrinë e Mbrojtjes.

1.2 Përfaqësia përkatëse paraqet kërkesën për pajisjen me kartë identiteti pranë Drejtorisë së Protokollit të Shtetit, në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Kartat e identitetit lëshohen vetëm pasi është dhënë viza e qëndrimit nga Drejtoria Konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme, me përjashtim të rasteve kur me marrëveshje dypalëshe parashikohet ndryshe.

1.3 Kërkesa bëhet me notë verbale të përfaqësisë diplomatike përkatëse, duke bashkëlidhur:

- formularin *"ID*-2018"* të plotësuar nga vetë anëtari i ri dhe të nënshkruar dhe vulosur nga shefi i përfaqësisë, në dy kopje origjinale me fotografi të ngjitura në secilën kopje (shih formularin *"ID*-2018"* në aneksin 1);
- dy fotografi me ngjyra me format 37 mm x 43 mm.

1.4 Kartat e identitetit lëshohen për një afat 2-vjeçar. Por afati maksimal i vlefshmërisë së tyre në çdo rast do të jetë në vartësi të afatit të vlefshmërisë së pasaportës të anëtarit të përfaqësisë për të cilin kërkohet karta.

1.5 Me mbarimin e vlefshmërisë, karta së bashku me kërkesën zyrtare për rinovim, i dërgohet Drejtorisë së Protokollit të Shtetit, duke ndjekur të njëjtën procedurë sipas rregullave të përcaktuara në pikën 2.

1.6 Me karta identiteti jeshile pajisen agjentët diplomatikë rezidentë në Shqipëri, bashkëshortet dhe fëmijët e tyre, mbajtës të pasaportave diplomatike, të cilët shoqërojnë diplomatin dhe nuk janë shtetas shqiptarë, si dhe përfaqësuesit diplomatikë jorezidentë të akredituar në Republikën e Shqipërisë.

1.7 Me karta identiteti të verdha pajisen mbajtësit e pasaportave të shërbimit dhe speciale, duke përfshirë anëtarët e familjeve të tyre që banojnë me ta dhe që nuk janë shtetas shqiptarë.

1.8 Me karta identiteti blu pajisen konsujt e nderit pavarësisht nga shtetësia e tyre.

1.9 Me karta identiteti rozë pajisen anëtarët e misioneve të organizatave ndërkombëtare mbajtës të pasaportave të zakonshme që nuk janë shtetas shqiptarë.

1.10 Kur bëhet kërkesë për pajisjen me kartë identiteti të atasheve ushtarakë, ajo duhet të shoqërohet edhe me fotokopjen e akreditimit dhënë nga Ministria e Mbrojtjes.

1.11 Në rastin kur një anëtar i një përfaqësie diplomatike ose i një organizate ndërkombëtare mbaron misionin e tij, ai është i detyruar të dorëzojë kartën e identitetit diplomatik.

1.12 Kur një anëtar i një përfaqësie diplomatike ose organizate ndërkombëtare humb kartën e identitetit, duhet të bëhet menjëherë denoncimi pranë komisariatit të policisë.

1.13 Kur karta e identitetit dëmtohet ose del jashtë përdorimit, ajo zëvendësohet me një të re. Për këtë ndiqet e njëjta procedurë si për pajisjen për herë të parë.

1.14 Kartat e identitetit duhet të kthehen në Drejtorinë e Protokollit të Shtetit pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme kur mbaron afati i vlefshmërisë së saj ose 3–4 ditë përpara largimit të mbajtësit të saj.

2. Përcaktimi i familjes

2.1 Në Republikën e Shqipërisë gëzojnë të drejtën e privilegjeve dhe imunitetit diplomatik bashkëshortja e anëtarit të përfaqësisë diplomatike ose konsullore, fëmijët e tij të pamartuar nën moshën 18 vjeç, raste të fëmijëve me të meta mendore dhe që banojnë nën të njëjtën strehë me primarin.

2.2 Fëmijët e anëtarëve të përfaqësisë diplomatike e konsullore të moshës 18 deri 23 vjeç, mund të vazhdojnë të gëzojnë privilegjet dhe imunitetin, nëse vazhdojnë të ndjekin në mënyrë të plotë studimet e shkollës së lartë në Shqipëri.

2.3 Fëmijët e moshës mbi 18 vjeç, që nuk vazhdojnë shkollën ose të moshës mbi 23 vjeç, pasi të kenë mbaruar studimet e larta, nuk mund të vijojnë të kenë privilegjet dhe imunitetin, por mund të vazhdojnë të qëndrojnë në Shqipëri me statusin e vizës së vizitorit.

2.4 Çdo anëtar tjetër i familjes që mund të ketë lidhje gjaku me primarin, por nuk bën pjesë në personat e mësipërm, nuk gëzon statusin e privilegjeve apo imunitetin.

3. Punësimi i pjesëtarëve të familjes së diplomatit

3.1 Në Republikën e Shqipërisë lejohet të punësohen pjesëtarët e aftë për punë të familjeve të anëtarëve të përfaqësive diplomatike dhe organizatave ndërkombëtare kur ka marrëveshje dypalëshe dhe respektohet reciprociteti.

3.2 Leja e punës jepet në respektim të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe miratimit nga Protokolli i Shtetit të kërkesës së paraqitur.

4. Shërbyesit privatë

4.1 Personeli diplomatik e konsullor i huaj në Shqipëri mund të sjellë me vete shërbyes të huaj nga vendi i origjinës ose nga një shtet i tretë. Pajisja e tyre me vizë hyrëse në Shqipëri dhe statusi i qëndrimit përcaktohen mbi bazën e reciprocitetit.

4.2 Të gjithë shërbyesit privatë, qofshin edhe shqiptarë, të punësuar nga personeli diplomatik i përfaqësive të huaja, i duhen bërë të njohur Protokollit të Shtetit. Në përputhje me këtë dërgohet në Protokollin e Shtetit, jo më vonë se 15 ditë nga fillimi i punës, dokumenti përkatës "Letër punësimi".

4.3 Nuk ka limit në marrjen në punë të personelit shërbyes. Shpërblimi i tyre duhet të parashikojë edhe të gjitha përfitimet e tjera si sigurimet shoqërore, shëndetësore që iu takojnë sipas legjislacionit shqiptar të punës në fuqi.

4.4 Shërbyesit e huaj të punësuar nga personeli i përfaqësive diplomatike në Shqipëri, pajisen me kartën e tyre të identitetit ngjyrë portokalli.

5. *Pajisja me targa CD, TR dhe HCC (të gjelbra)*

5.1 Numri i automjeteve, të importuara apo të blera në vend, nga misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare, të nevojshme për përdorim zyrtar, duhet të jetë i arsyeshëm dhe në përputhje me madhësinë dhe të nevojat e misionit. Automjetet pajisen me targë CD ose TR (jeshile). Ky rregull zbatohet edhe për automjetet, e importuara apo të blera në vend, nga agjencitë e specializuara të OKB-së, të cilat pajisen me targë CD.

5.2 Shefat e misioneve diplomatike dhe të organizatave ndërkombëtare, që me marrëveshje dypalëshe janë të barazuara me misionet diplomatike, mund të importojnë në emër të tyre, pa taksa doganore, pa TVSH dhe taksa të tjera, dy automjete për përdorim personal, njëra prej të cilave jepet për bashkëshortin/en, të cilat pajisen me targë CD.

5.3 Përfaqësitë diplomatike, konsullatat e nderit, organizatat ndërkombëtare, si dhe agjencitë e specializuara të OKB-së në Shqipëri, mund të shesin një automjet të importuar pa taksa doganore, pa TVSH dhe taksa të tjera, qoftë ajo edhe e shërbimit zyrtar apo personal, pas kalimit të një periudhe kohe minimumi 2 vjet nga importimi pa taksa doganore, pa TVSH dhe taksa të tjera ose nga shitja e fundit pa taksa doganore, pa TVSH dhe taksa të tjera e një autoveture, mbi bazën e reciprocitetit.

5.4 Shefat e agjencive të specializuara të OKB-së, në Shqipëri mund të importojnë, në emër të tyre, pa taksa doganore, pa TVSH dhe taksa të tjera, një automjet për përdorim personal, i cili pajiset

me targë CD. Mund të importohet ose të blihet në vend, pa taksa doganore, pa TVSH dhe taksa të tjera, edhe një automjet tjetër shtesë, nëse personat në fjalë janë të shoqëruar nga bashkëshortja/i.

5.5 Anëtarët e përfaqësive diplomatike, të organizatave ndërkombëtare dhe të agjencive të specializuara të OKB-së, mbajtës të pasaportave diplomatike, mund të importojnë ose të blejnë në vend, pa taksa doganore, pa TVSH dhe taksa të tjera, një automjet, ekskluzivisht për t'u përdorur prej tyre. Mund të importohet ose të blihet në vend, pa taksa doganore, pa TVSH dhe taksa të tjera, edhe një automjet tjetër shtesë, nëse anëtari është i shoqëruar nga bashkëshorti/ja. Automjetet pajisen me targë CD.

5.6 Anëtarët e përfaqësive diplomatike, organizatave ndërkombëtare dhe agjencive të specializuara të OKB-së, mbajtës të pasaportave të shërbimit apo speciale, do të lejohen të importojnë ose të blejnë në Shqipëri pa taksa doganore, pa TVSH dhe taksa të tjera, një automjet, menjëherë mbas marrjes së detyrës ose vetëm brenda gjashtë muajve nga dita e mbërritjes së tyre në Shqipëri. Automjeteve u jepet targa TR (jeshile).

5.7 Kërkesa për pajisjen me targë CD ose TR (jeshile) të automjeteve personale bëhet vetëm pas pajisjes, nga protokolli i shtetit, me kartë identiteti të anëtarit të përfaqësisë diplomatike, të organizatës ndërkombëtare dhe agjencive të specializuara të OKB-së, si dhe të bashkëshortit/es.

5.8 *Konsujt e nderit, të emëruar në Republikën e Shqipërisë, kanë të drejtë të përdorin për qëllime pune, në funksion të pozicionit të tyre, jo më shumë se një automjet personal me targa, me inicialet dalluese "HCC", automjet i cili përjashtohet nga detyrimet doganore dhe TVSH-ja, të zbatuara në shitblerjen e automjeteve në Republikën e Shqipërisë.*

5.9 Anëtarët e përfaqësive diplomatike, mbajtës të pasaportave diplomatike, mund të importojnë ose të blejnë në vend, pa taksa doganore, pa TVSH dhe taksa të tjera, ekskluzivisht për përdorim personal, një motoçikletë. Për pajisjen e motoçikletave personale me targë CD ndiqet e njëjta procedurë si për automjetet.

5.10 Organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë e specializuara të OKB-së, mbi bazën e marrëveshjeve të nënshkruara me qeverinë e Republikës së Shqipërisë, mund të importojnë automjete që përjashtohen nga pa taksa doganore, pa TVSH dhe taksa të tjera, për projektet e ndryshme, veprimtaria e të cilave varet dhe mbështetet prej tyre. Këto automjete marrin targa të zakonshme shqiptare dhe përdorin si shenja dalluese inicialet apo simbolet e organizatave ose projekteve të tyre.

5.11 Një autoveturë e importuar pa taksa doganore, pa TVSH dhe taksa të tjera, nga një përfaqësi diplomatike apo organizatë ndërkombëtare e akreditуar në Shqipëri, nga një agjent i tyre diplomatik apo një anëtar i personelit administrativ dhe teknik të tyre, mund të transferohet pa taksë doganore dhe taksa të tjera te një përfaqësi diplomatike apo organizatë ndërkombëtare e akreditуar në Shqipëri, te një agjent i tyre diplomatik apo një anëtar i personelit administrativ dhe teknik të tyre ose te një person tjetër me status të njëjtë, ose të rieksportohet, pasi të jetë bërë njoftimi dhe veprimet përkatëse të çregjistrimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

5.12 Aksesorët, komponentët dhe pjesët e këmbimit të automjeteve të importuara, pa taksa doganore, pa TVSH dhe taksa të tjera, nga anëtarët e personelit diplomatik dhe administrativ dhe teknik të misioneve të përmendura më sipër, konsiderohen si pjesë përbërëse e këtyre automjeteve. Në rast shitje të automjetit nga pronarët e tyre, këto pjesë shkojnë bashkë me automjetin. Në të kundërt, nëse pronari dëshiron t'i mbajë ato, ai duhet të paguajë tatimet dhe taksat përkatëse doganore.

5.13 Kur importohet një automjet për herë të parë, agjenti diplomatik ose personeli administrativ i misionit duhet ta paraqesë atë për kryerjen e veprimeve doganore. Kjo nevojitet si për regjistrimin e hyrjes së automjetit në Shqipëri, ashtu edhe për vërtetimin e datës së importimit.

5.14 Për pajisjen e automjeteve me targë CD, TR (jeshile) dhe HCC dhe me lejeqarkullimi, përfaqësitë diplomatike, organizatat ndërkombëtare, agjencitë e specializuar të OKB-së dhe

konsullatat e nderit, duhet të paraqesin kërkesën, me notë verbale, në protokollin e shtetit, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ku duhet të shënojnë qëllimin, për të cilin do të përdoret automjeti, emrin e pronarit, tipin e automjetit, numrin e shasisë, ngjyrën, si dhe një kopje të dokumentit administrativ të vetëm (DAV) import 4, sipas legjislacionit doganor në fuqi, të vërtetimit të hyrjes së automjetit, të lëshuar nga dogana ku është zhdoganuar, dokumentin e hyrjes, të lëshuar nga pika e kalimit kufitar, dhe fotokopjen e kartës së identitetit, në rastin kur automjeti është për përdorim personal. Nota duhet të dërgohet në protokollin e shtetit. Pas kësaj, përfaqësia diplomatike, organizatat ndërkombëtare ose konsujt e nderit dorëzojnë notën në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila i pajis këto automjete me leje qarkullimi dhe me targë CD, TR (jeshile) apo HCC.

15.5 Në rastin kur makina shitet brenda përfaqësisë diplomatike, organizatës ndërkombëtare ose midis tyre, nota verbale e dërguar në Protokollin e Shtetit, duhet të shoqërohet nga fotokopjet e kontratës së shitblerjes, lejeqarkullimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, si dhe fotokopjen e kartës së identitetit të personave që kanë bërë shitblerjen në rastin kur makina është për përdorim personal.

5.16 Targat CD, TR (jeshile) dhe HCC nuk janë të transferueshme, kur automjeti që i mban ato, shitet ose ndryshon pronësi, në çfarëdolloj mënyre.

5.17 Në rastet kur një anëtar i një përfaqësie diplomatike shet automjetin e tij dhe blen një tjetër, targat e automjetit të parë nuk janë të transferueshme tek automjeti i dytë.

5.18 Numri i targave do të jetë në mënyrë progresive, me përjashtim të ambasadorit ose të përfaqësuesit të organizatës, i cili do të mbajë në automjetin e vet, zyrtar dhe personal, nr. 001.

5.19 Përfaqësitë diplomatike, konsullatat e nderit, organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë e specializuara të OKB-së, pas pajisjes së automjetit me targë CD, TR (jeshile), *ose HCC* duhet të njoftojnë protokollin e shtetit, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, për numrin e targës së dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Gjithashtu, kjo e fundit, duhet të njoftojë protokollin e shtetit për targat e dhëna.

5.20 Për drejtimin e automjeteve në territorin e Republikës së Shqipërisë, të gjithë anëtarët e përfaqësisë diplomatike, konsullatave të nderit, organizatave ndërkombëtare, agjencive të specializuara të OKB-së në Shqipëri, si dhe anëtarët e familjeve të tyre, janë të detyruar të pajisen me lejedrejtimi shqiptare, e cila bëhet mbi bazën e ekuivalencës së dëshmisë që ka anëtari i misionit nga vendi i origjinës, vetëm në rastet kur ata qëndrojnë më shumë se një vit në Republikën e Shqipërisë. Pajisja bëhet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, në rastin kur nuk janë të pajisur me lejedrejtimi ndërkombëtare.

5.21 Përfaqësitë diplomatike, konsullatat e nderit, organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë e specializuara të OKB-së në Shqipëri, si dhe anëtarët e tyre, duhet të bëjnë sigurimin e automjetit për palë të treta.

5.22 Në rastet kur vidhet automjeti, duhet të bëhet menjëherë denoncimi pranë komisariatit të policisë dhe të njoftohet njëkohësisht Protokolli i Shtetit, shoqëruar me fotokopjen e procesverbalit të denoncimit.

5.23 Në rastet kur humbet targa e automjetit, duhet të bëhet menjëherë denoncimi pranë komisariatit të policisë dhe të njoftohet njëkohësisht Protokolli i Shtetit, shoqëruar me fotokopjen e procesverbalit të denoncimit.

5.24 Sipas rregullave ekzistuese, misionet, kur anëtarët e personelit, të çdo kategorie, pronarë të automjeteve pa taksa doganore, pa TVSH dhe taksa të tjera, që largohen përfundimisht nga Shqipëria, në mbarim të misionit zyrtar, në rastet kur marrin me vete automjetet, duhet të kthejnë, me notë verbale targën CD, TR (jeshile), si dhe lejet e qarkullimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Konsujt e nderit duhet të kthejnë *targën HCC* pranë protokollit të shtetit dhe, pas kësaj, të bëjnë njoftimin në protokollin e shtetit. Nota verbale duhet të shoqërohet me fotokopjen e dokumentit të çregjistrimit, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

6. Armët dhe mbajtja e tyre

6.1 Leja e mbajtjes dhe e përdorimit të armëve nga anëtarët e përfaqësive diplomatike bëhet në bazë të reciprocitetit ose kur parashikohet me marrëveshje në rastet e anëtarëve të organizatave ndërkombëtare.

6.2 Për pajisjen me armë gjahu dhe përdorimin e tyre dërgohet një notë verbale pranë Protokollit të Shtetit, sektori i privilegjeve dhe imuniteteve. Në notë verbale duhet të jetë shkruar emri i anëtarit të përfaqësisë diplomatike, fotokopja e kartës së identitetit lëshuar nga ky sektor, si dhe marka dhe numri i armës që do të zotërohet.

6.3 Për pajisjen me leje për armëmbajtje dhe përdorimin e tyre veprohet në zbatim të legjislacionit në fuqi.

6.4 Në rastet kur, gjatë një vizite zyrtare personalitetet e huaja shoqërohen me truprojë të pajisur me armë, përfaqësia diplomatike me notë verbale, krahas gjenealiteteve të truprojës, duhet të dërgojë në Drejtorinë e Protokollit të Shtetit edhe të dhënat e armës që ai mban. Të dhënat përkatëse i përcillen Ministrisë së Punëve të Brendshme.

7. Mbajtja e kafshëve shtëpiake

7.1 Anëtarët e përfaqësive diplomatike mund të sjellin në Shqipëri qenie të gjalla të çdo lloji. Lejimi i kalimit të tyre është subjekt i rregullave dhe i kufizimeve ligjore në fuqi deri në mbajtjen në karantinë të tyre.

7.2 Të tilla konsiderohen të gjithë gjitarët, shpendët, peshqit, molusqet, zvarranikët, të gjallë ose në statusin e vezës.

7.3 Personat e sipërpërmendur duhet të bëjnë të ditur llojin e qenies që bashkëjeton me ta dhe të gjitha dokumentet përkatëse që vërtetojnë se është e vaksinuar dhe që gëzon shëndet të plotë.

7.4 Rregullat e vaksinimit:

- qentë dhe macet duhet të jenë vaksinuar kundër tërbimit dhe sëmundjeve të tjera të rrezikshme, të paktën 30 (tridhjetë) ditë para hyrjes në Shqipëri. Konet nën 3 (tre) muaj, regjistrohen dhe vaksinohen në Shqipëri në kohën e përshtatshme;
- të gjitha vaksinat dhe sëmundjet e kaluara duhet të jenë të reflektuara në certifikatën përkatëse veterinare të kafshës. Nëse vaksinimi është bërë në më pak se 30 (tridhjetë) ditë, i zoti duhet të mbajë kafshën të izoluar deri në kohën e duhur. E njëjta certifikatë veterinare që të dëshmojë shëndetin e mirë, duhet të shoqërojë edhe kategorinë e shpendëve shtëpiake.

7.5 Është e ndaluar futja dhe mbajtja në Shqipëri e qenieve të rralla dhe të mbrojtura nga ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Subjektet që veprojnë në të kundërt janë të detyruar t'i kthejnë ato në vendin nga i kanë sjellë duke përballuar tërë shpenzimet përkatëse.

8. Rimbursimi i TVSH-së

8.1 Rimbursimi i tatimit mbi vlerën e shtuar nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi.

9. Posta dhe valixhja diplomatike

9.1 Shkëmbimi i valixhes diplomatike do të bëhet në transitin e Aeroportit të Rinasit.

9.2 Përfaqësuesi i përfaqësisë diplomatike, i pajisur me kartë të posaçme identifikimi, do të futet në transitin e aeroportit, ku do të takohet me personin i cili sjell me vete çantën diplomatike.

9.3 Posta diplomatike do të merret nga përfaqësuesit e përfaqësive diplomatike dhe organizatave ndërkombëtare të akredituara në Tiranë, në kargo.

9.4 Ndalohet hyrja në pistë e personave dhe e automjeteve.

9.5 Protokolli i Shtetit pajis me karta të posaçme, ngjyrë të bardhë, të gjithë personat e ngarkuar për tërheqjen e valixhes diplomatike nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në Tiranë.

9.6 Karta për tërheqjen e valixhes diplomatike konsiderohet e vlefshme vetëm kur është e shoqëruar me kartën e identitetit diplomatik ose të shërbimit lëshuar nga Protokolli i Shtetit.

9.7 Pajisja me kartë për tërheqjen e valixhes ose postës diplomatike bëhet me anë të një note verbale nga përfaqësia diplomatike drejtuar Protokollit të Shtetit. Nota duhet të shoqërohet edhe me fotokopjen e kartës së identitetit të personit. Afati i saj skadon me afatin e kartës së identitetit të lëshuar nga Protokolli i Shtetit.

10. Votimet

10.1 Përfaqësia diplomatike mund të hapë në lokalet e saj qendër votimi për zgjedhjet që zhvillohen në vendin e saj pa kërkuar leje të posaçme. Nëse gjykon të domosdoshme hapjen e një qendre votimi jashtë lokaleve të përfaqësisë diplomatike, si ndërtesë shkolle ose objekt tjetër publik apo privat përfaqësia duhet të informojë zyrtarisht Protokollin e Shtetit.

10.2 Hapja e qendrës së votimit nuk bëhet pjesë e objeksioneve nga ana e autoriteteve shqiptare. Nëse përfaqësia diplomatike ka nevojë për ndihmë nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme apo nga ministria përkatëse shqiptare për të siguruar lokalin publik për qendrën e votimit, ajo i drejtohet me kërkesë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

10.3 Lidhur me përdorimin e masmedias për efekte të procesit zgjedhor, përfaqësia diplomatike u drejtohet direkt institucioneve përkatëse.

10.4 Lidhur me publikimin dhe afishimin e posterave të votimit përfaqësia diplomatike i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë.

10.5 Përfaqësia diplomatike këshillohet të informojë jo më pak se 1 (një) muaj përpara datës së votimit Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Shërbimin Informativ Shtetëror për kohën dhe vendin e planifikuar për qendër votimi.

KAPITULLI VIII
SKEMAT TË CEREMONIVE SHTETËRORE DHE ZYRTARE

Vendosja e kurorave te monumenti "Nënë Shqipëri"

1 Presidenti i Republikës
2 Kryetari i Kuvendit
3 Kryeministri
4 Ministri i Mbrojtjes
5 Shefi i Shtabit të Përgjithshëm
6 Prefekti i Tiranës
7 Kryetari i Bashkisë
8 Kryetari i Qarkut
9 Veteranët



Ceremonia

Ecje solemne me marsh funebër.
Vendosja e kurorës dhe prekje me dorë e shiritit të kuq.
Kthim në vendin e nisjes.
Mbajtje e momentit të heshtjes.
Përkulje e lehtë para monumentit "Nënë Shqipëri".
Ekzekutim i himnit kombëtar.
Largim i autoriteteve sipas radhës duke takuar popullin,
(kurora mbahet nga ushtarë me uniformë ceremoniale, kurse autoriteti qëndron 1,5 m pas tyre).

Ceremonia e fillimit të detyrës së Presidentit të Republikës

Ish-Presidenti



Betimi i qeverisë



Ceremonia e vendosjes së kurorës në Varrezat e Dëshmorëve nga një president mik



1. Mbërritja e Presidentit mik. Priten nga kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe komandanti i Gardës së Republikës (1).

2. Presidenti ecën mbas ushtarëve ceremonialë që mbajnë kurorën. Delegacioni vjen mbas tij. Ekzekutohen marshe funebre (2).

3. Delegacioni qëndron në një radhë (3).

4. Presidenti qëndron (4).

5. Ushtarët vendosin kurorën (5). Presidenti rregullon kurorën dhe kthehet në pozicionin (4). Ekzekutohet himni kombëtar. Përulet. Bashkohet me delegacionin dhe ecën drejt makinave.

6. Ndahet me autoritetet shqiptare (1).

Pritje në aeroport



Mbërritja dhe lëvizja e autoritetit

Ambasadori i vendit mik

Protokolli

O Truproja e nderit pa bande

Lëvizja e suitës

Makinat

Shënime të ndryshme :

Përcjellja në aeroport

Shënime të ndryshme :





Pritja ceremoniale në Pallatin e Brigadave



1. Mbërritja e Presidentit mik dhe Zonjës. Drejtori i protokollit e shoqëron dhe prezanton me Presidentin shqiptar dhe Zonjën. Pjesa tjetër e delegacionit drejtohet në vendin e paracaktuar për ta.

2. Të dy presidentët takohen dhe nisen drejt podiumit të nderit. Zonjat qëndrojnë mbrapa tyre.

3. Komandanti i truprojës së nderit i paraqet forcën Presidentit mik. Pas paraqitjes së forcës fillon ekzekutimi i himnit kombëtar mik dhe atij shqiptar. Ekzekutimi i himneve shoqërohet me 21 të shtëna topi për nder të Presidentit mik.

4. Pas mbarimit të himneve të dy presidentët kalojnë në revistë truprojën e nderit (gjatë kalimin në revistë autoriteti mik kalon në krah të truprojës së nderit), ndalojnë para flamurit shqiptar dhe përshëndesin me një përkulje të lehtë.

5. Banda shoqëron me marsh ecjen e dy presidentëve.

6. Presidenti mik i prezanton anëtarët e delegacionit të tij Presidentit shqiptar. Presidenti shqiptar i prezanton delegacionin e tij Presidentit mik dhe drejtohen për në hyrjen e Pallatit të Brigadave. Zonjat bashkohen me dy presidentët në shkallët e para të Pallatit të Brigadave.

7. Protokolli shoqëron të dy presidentët për vazhdimin e programit në mjediset e përcaktuara për ta.

Pritje dhe përcjellje në takime shumëpalëshe
(summit)



(Ndryshuar formulari ID-2018 me VKM nr. 587, datë 9.10.2018)*

Formular ID-2018

FORMULAR APLIKIMI PER KARTE IDENTITETI LEGJITIMITETI
APPLICATION FORM FOR LEGITIMATION ID CARD

A. PERFAQESIA / MISSION

Lutemi ngjitni një foto me ngjyra
Please glue a colour photo
45 mm
35 mm

B. Emri / First Name | Mbiemri / Family Name | Mbiemri Vajzërisë / Maiden Name

Datëlindja / Date of Birth (dd-mm-yyyy) | Vendlindja / Place of Birth (Qyteti, Shteti / City, Country)

Shtetësia / Citizenship | Shtetësi të Tjera / Other Citizenships | Seksi / Sex M ☐ F ☐

C. Tipi i Pasaportës / Passport Type: Lutemi Zgjidhni / Please Select | Nëse Tjetër / If Other (Lutemi Specifikoni / Please Specify) | Autoriteti Lëshues/ Issuing Authority

Nr. i Pasaportës / Passport No. | Data e Lëshimit / Date of Issue (dd-mm-yyyy) | Data e Skadimit / Date of Expiry (dd-mm-yyyy)

Lloji i Vizës / Type of Visa | Data e Hyrjes së Parë / Date of First Entry (dd-mm-yyyy) | Karta që kërkohet / Requested card: E re / New ☐ Rinovim / Renewal ☐

D. Grada Diplomatike ose Titulli Zyrtar / Diplomatic Rank or Official Title

Fillimi i Misionit / Mission Start (dd-mm-yyyy)

Detyra e Ngarkuar / Area of Responsibility

Mbarimi i Pritshëm / Expected End (mm-yyyy)

Emër, Mbiemër i Paraardhësit / Name, Surname of Predecessor

Telefoni i Zyrës / Office Phone

Specifikoni nëse është post i ri / Specify if it is a new post

Adresa e Zyrës / Office Address | Adresa e Shtëpisë / Home Address

E. Posti i mbajtur para emërimit në këtë detyrë dhe ku / Position held before this assignment and where

F. Lista e anëtareve të familjes që shoqërojnë zyrtarin / List of family members who accompany the official

#	Emri / First Name	Mbiemri / Last Name	Lidhja me Zyrtarin / Relation to the Official	Datëlindja / Date of Birth
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				

Data / Date (dd-mm-yyyy)

Firma / Signature:

Head of Mission
Shefi i Përfaqësisë

Print Form

Vula e Përfaqësisë

Seal of the Mission

Udhëzime për plotësimin e formularit:
1. Zyrtarët duhet të plotësojnë të gjitha seksionet e formularit. Data e mbarimit të pritshëm të misionit lihet bosh nëse nuk dihet.
2. Për anëtarët e familjes, në kutinë "Grada Diplomatike ose Titulli Zyrtar" vendoset lidhja me zyrtarin/zyrtaren, si dhe titulli dhe emri i tij/e saj. Kutia "Detyra e Ngarkuar" (nëse nuk i është dhënë detyrë), paraardhesi, post i ri, si dhe seksionet E dhe F lihen bosh.

Instructions for filling the application form:
1. The officials should fill all sections of the application form. The date of expected mission end is omitted if not known.
2. For family members, in the field "Diplomatic Rank or Official Title" it is entered the relation to the official, as well as his/her title and name. The field "Area of Responsibility" (if no task assigned) predecessor, new post and the sections E and F are omitted.

Protokolli i Shtetit / State Protocol

Nr. Kartës _____ Lëshuar më _____ /_____ /_____ E vlefshme deri _____ /_____ /_____

Nëpunësi _____ Marrësi në dorëzim _____
(Emër Mbiemër) (Emër Mbiemër)